





Save the Children®



QERSHOR, 2020

PROGRAM PLOTËSUES PËR LËNDËT “GJUHË SHQIPE” DHE “MATEMATIKË” NË KLASAT I-V


NJOHURITË DHE AFTËSITË KRYESORE
TË ZHVILLUARA
GJATË MËSIMIT NË KUSHTET E SHTËPISË
MARS –QERSHOR 2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

**PROGRAM PLOTËSUES
PËR LËNDËT
“GJUHË SHQIPE” DHE “MATEMATIKË”
NË KLASAT I-V**

**NJOHURITË DHE AFTËSITË KRYESORE
TË ZHVILLUARA
GJATË MËSIMIT NË KUSHTET E SHTËPISË
MARS –QERSHOR 2020**



QERSHOR, 2020

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	HYRJE	3
2.	KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT PLOTËSUES	4
3.	PROGRAMI PLOTËSUES PËR LËNDËN E GJUHËS SHQIPE.....	4
3.1.	Qëllimet e programit plotësues për gjuhën shqipe	5
3.2.	Lidhja e kompetencave kyç me kompetencat gjuhësore.....	6
3.4.	Koha mësimore	10
3.5.	Përmbajtja e programit plotësues sipas klasave	10
3.5.1.	KLASA E PARË.....	10
3.5.2.	KLASA E DYTË	13
3.5.3.	KLASA E TRETË	17
3.5.4.	KLASA E KATËRT	20
3.5.5.	KLASA E PESTË	24
4.	Udhëzime metodologjike për zbatimin e programit plotësues në gjuhën shqipe	29
5.	PROGRAMI PLOTËSUES PËR LËNDËN E MATEMATIKËS.....	30
5.1.	Qëllimi i programit plotësues të matematikës.....	30
5.2.	Lidhja e kompetencave kyç me kompetencat matematikore	31
5.3.	Kompetencat matematikore që formohen përmes tematikave të saj.....	33
5.4.	Koha mësimore	36
5.5.	Përmbajtja e programit plotësues sipas klasave	37
5.5.1.	KLASA E PARË.....	37
5.5.2.	KLASA E DYTË	40
5.5.3.	KLASA E TRETË.....	42
5.5.4.	KLASA E KATËRT	45
5.5.5.	KLASA E PESTË.....	48
5.5.6.	Udhëzime metodologjike për zhvillimin e programit plotësues të matematikës	50

1. HYRJE

Pandemia COVID-19 është një sfidë e madhe për të gjithë shoqërinë, përfshirë edhe sistemin arsimor. Shumica e vendeve në Evropë dhe më gjerë i mbyllën institucionet arsimore gjatë periudhës mars - qershor 2020, si pjesë e masave të tyre për të kufizuar kontaktin mes njerëzve dhe për të parandaluar përhapjen e virusit. Edhe në vendin tonë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) i ka mbyllur institucionet arsimore që nga data 9 mars 2020.

Gjatë kësaj periudhe, MASR dhe ASCAP mbështetën mësuesit në përpjekjet e tyre për të zbutur ndikimin e mbylljes së menjëhershme të shkollave, si dhe për të mundësuar vazhdimësinë e procesit mësimor përmes mësimit në distancë (mësimit në kushtet e shtëpisë).

Gjithashtu, MASR dhe ASCAP kanë bashkëpunuar me organizatat, bizneset, shtëpitë botuese etj., me qëllim:

- hartimin e udhëzuesve në ndihmë të mësuesve, nxënësve dhe prindërve;
- evidentimin dhe zgjidhjen e problematikave të mësimit në kushtet e shtëpisë;
- ofrimin e shërbimit psikologjik për nxënësit;
- trajnimin e mësuesve për përdorimin e platformave online;
- sigurimin e pajisjeve digjitale për fëmijët nga shtresat në nevojë etj.

Mësimi në distancë ka bërë të mundur që pjesa më e madhe e nxënësve të vijnë me realizimin e njohurive dhe të aftësive që kërkon kurrikula, megjithatë ka nxënës nga shtresat vulnerabël ose nga zona të thella gjeografike, të cilët nuk kanë mundur ta ndjekin mësimin në distancë. Sipas sondazheve të organizuara nga MASR dhe ASCAP, rezultoni që afërsisht 10000 fëmijë nga arsimi parauniversitar nuk kanë marrë pjesë në këtë mësim.

Në një situatë të tillë, të gjitha institucionet shtetërore, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare, duhet të angazhohen për t'u siguruar të gjithë fëmijëve, të drejtën për arsimim dhe barazi. Format kryesore që duhen përdorur janë mësimet shtesë dhe programet plotësuese për fëmijët para se të nisë viti shkollor 2020-2021. Për shkak të specifikave të moshës, por edhe sepse njohuritë dhe aftësitë bazë fëmija i fiton gjatë arsimit fillor (klasat 1-5), mbështetja për këtë grup-moshë është shumë e rëndësishme.

Në këtë kuadër është hartuar programi plotësues për nxënësit e klasave 1-5, të cilët nuk kanë mundur të ndjekin mësimin në distancë gjatë periudhës mars-qershor 2020, si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19. Qëllimi i këtij programi është pajisja e nxënësve të klasave 1-5 me njohuritë dhe aftësitë gjuhësore dhe matematikore që i përkasin periudhës mars-qershor.

Programi plotësues është përqendruar te gjuha shqipe dhe te matematika, pasi këto lëndë zhvillojnë te nxënësit kompetencat më të rëndësishme, të cilat janë jo vetëm kusht për nxënien e të gjitha lëndëve në shkollë, por janë edhe kompetenca themelore për jetën.

Në varësi të situatës së pandemisë COVID -19, zbatimi i programit plotësues do të realizohet duke zbatuar të gjitha rregullat e distancimit fizik. Mësuesit duhet të edukojnë te nxënësit zbatimin e këtyre rregullave. Gjithashtu, është e rëndësishme që paralelisht me procesin mësimor, të vijojë mbështetja e nxënësve dhe të sigurohet mirëqenia psiko-emocionale e tyre.

2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT PLOTËSUES

Programi plotësues ka dy pjesë:

- Programi plotësues për lëndën e gjuhës shqipe, klasat 1-5
- Programi plotësues për lëndën e matematikës, klasat 1-5

Për secilën lëndë janë dhënë: koha mësimore, njohuritë dhe aftësitë sipas klasave dhe udhëzime metodologjike për zbatimin e programit plotësues.

Përdoruesit e këtij programi janë: mësuesit, drejtoritë e shkollave, nxënësit, prindërit dhe specialistët e arsimit.

Mësuesit do ta përdorin programin plotësues për të pasur një tablo të qartë rreth njohurive dhe aftësive kryesore gjuhësore dhe matematikore që duhet të zotërojnë nxënësit dhe se si duhet të ndërtojnë mësimdhënien për të përmbushur kërkesat e programit plotësues.

Drejtuesit e shkollave do ta përdorin këtë program për të mbështetur dhe monitoruar mësuesit gjatë gjithë procesit të zbatimit të këtij programi.

Prindërit mund të informohen nëpërmjet programit për njohuritë, aftësitë, qëndrimet dhe vlerat që do të zotërojnë fëmijët e tyre, të cilët nuk patën mundësi të zhvillojnë mësimin në kushtet e shtëpisë (mësimin në distancë) gjatë periudhës mars-qershor 2020.

Specialistët e arsimit do ta përdorin programin plotësues për qëllime inspektimi, monitorimi, vlerësimi, studimi etj.

3. PROGRAMI PLOTËSUES PËR LËNDËN E GJUHËS SHQIPE

Lënda e gjuhës shqipe synon zhvillimin gjuhësor e letrar që është boshti themelor për rritjen intelektuale, shoqërore, estetike dhe emocionale të nxënësve. Më konkretisht, kjo lëndë i aftëson

nxënësit që ta përdorin gjuhën për të komunikuar, për të marrë informacion, për të lexuar për kënaqësi estetike, si dhe për të shprehur idetë, opinionet, qëndrimet dhe ndjenjat e tyre.

Mësimi i gjuhës shqipe, gjithashtu, i bën nxënësit të vetëdijshëm për identitetin e tyre personal dhe kombëtar. Nëpërmjet leximit të teksteve nga letërsia shqipe dhe ajo botërore, nxënësit zhvillojnë botën e tyre emocionale, pasurojnë përfytyrimet dhe imagjinatën e tyre për botën, çmojnë gjuhët dhe kulturën kombëtare e atë botërore.

Lënda e gjuhës shqipe nxit dëshirën dhe kuriozitetin e nxënësve për t'u bërë lexues aktivë e të pavarur dhe shkruar të saktë, origjinalë dhe krijues. Po kështu, ajo zhvillon te nxënësit njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat e duhura që ata të flasin dhe të dëgjojnë në mënyrë korrekte në varësi të situatës dhe të qëllimit që kanë.

Arritjet gjuhësore të nxënësve janë përcaktuese për çdo lëndë që zhvillohet në shkollë. Gjithashtu, nëse nxënësit nuk janë të aftë të dëgjojnë, të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë mirë, ata nuk mund të jenë të suksesshëm në shkollë dhe në jetë. Duke pasur një rëndësi të tillë, lënda e gjuhës shqipe është një nga detyrat parësore të arsimit bazë.

Korniza kurrikulare përcakton si qëllim kryesor zotërimin e kompetencave kyç, si të domosdoshme për një individ me qëllim që ai të përmbushë me sukses kërkesat personale, shoqërore dhe profesionale. Çdo lëndë synon që ta pajisë nxënësin me këto kompetenca. Këtë “mision” lënda e realizon duke zhvilluar kompetencat e saj. Bazuar në synimet dhe specifikat e lëndës së gjuhës shqipe, pesë kompetencat e saj janë:

- Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme.
- Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar.
- Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare.
- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale.
- Përdorimi i drejtë i gjuhës.


3.1. Qëllimet e programit plotësues për gjuhën shqipe

Qëllimet e programit plotësues për lëndën e gjuhës shqipe janë:

- Ndërtimi dhe zhvillimi i njohurive dhe i aftësive kryesore gjuhësore (klasat 1-5) te fëmijët vulnerabël, të cilët nuk kanë pasur mundësi të ndjekin mësimin në kushtet e shtëpisë (mësimin në distancë), gjatë periudhës mars- qershor 2020.
- Zhvillimi i aftësive për të folur, për të dëgjuar, për të lexuar dhe për të shkruar tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe jo letrare, si dhe kultivimi i mendimit kritik e krijues nëpërmjet këtyre teksteve.
- Zotërimi i njohurive, aftësive, shkathtësive dhe qëndrimeve të duhura rreth sistemit gjuhësor të shqipes.
- Përgatitja e nxënësve të klasave 1-5, të cilët nuk kanë ndjekur mësimin në kushtet e shtëpisë, për vitin e ardhshëm shkollor 2020-2021

3.2. Lidhja e kompetencave kyç me kompetencat gjuhësore

Gjatë zbatimit të programit plotësues, përveç ndërtimit dhe zhvillimit të kompetencave lëndore, mësuesit duhet të vijojnë punën edhe për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave kyç te nxënësit. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesit duhet të përzgjedhin metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të nxëni. Kur nxënësi realizon kompetencat gjuhësore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyç. Diagrami i mëposhtëm konkretizon lidhjen e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës.



Në tabelën e mëposhtme pasqyron rezultatet e të nxënit të kompetencave kyç që realizohen nëpërmjet programit plotësues të gjuhës shqipe.

SHKALLA I Klasat 1 -2	SHKALLA II Klasat 3-5
Nxënësi:	
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit	
<ul style="list-style-type: none"> - shpreh me gojë dhe me shkrim, për 3-5 minuta, përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë leximit ose gjatë dëgjimit të një teksti; - lexon saktë dhe rrjedhshëm një tekst (afërsisht gjysmë faqeje); - shkruan një tekst të shkurtër (gjysmë faqe) për një temë të caktuar; - identifikon personazhet kryesore të një teksti letrar dhe, në bashkëveprim me moshatarët, luan rolin e njërit prej personazheve. 	<ul style="list-style-type: none"> - shpreh përjetimet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit ose gjatë leximit të një teksti në njërën nga format shprehëse: me gojë, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.; - dëgjon me vëmendje prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim me pyetje, komente apo sqarime; - lexon saktë dhe rrjedhshëm një tekst letrar ose jo letrar; - shkruan një tekst (rreth një faqe) për një temë të caktuar; - identifikon personazhet kryesore të një teksti, i analizon duke bërë një listë me tiparet e tyre, diskuton rreth tyre dhe në bashkëveprim me moshatarët, luan rolin e njërit prej personazheve.
Kompetenca e të menduarit	
<ul style="list-style-type: none"> - sqaron me anë të të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë, me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore. 	<ul style="list-style-type: none"> - paraqet argumente <i>pro</i> dhe <i>kundër</i> për një mendim, qëndrim, sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
Kompetenca e të nxënit	
<ul style="list-style-type: none"> - ndjek udhëzimet e dhëna në një tekst për të realizuar një detyrë që i kërkohet; - zgjidh në mënyrë të pavarur problemin ose detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes; - mbikëqyr në mënyrë të pavarur 	<ul style="list-style-type: none"> - identifikon dhe krahason informacionet e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuara, duke përdorur teknika të ndryshme; - krahason përparimin e tij me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një veprimtarie të caktuar;

përparimin e vet në një detyrë ose në një veprimtari duke përdorur teknika të ndryshme për gjetjen e gabimeve dhe i korrigjon ato.	- identifikon cilësitë që zotëron dhe ato që duhen zhvilluar gjatë kryerjes së një detyre apo veprimtarie, duke bashkëpunuar me të tjerët.
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin	
- përgatit me shkrim një plan ditor të thjeshtë, për dy- tri aktivitete ditore, duke marrë parasysh kohën, vendin, materialet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e detyrës; - identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjete etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/veprimtarie në klasë, në shkollë, në shtëpi.	- prezanton veten, të dhënat personale dhe prirjet që ka në fusha të caktuara; - diskuton në situata të ndryshme, duke prezantuar idetë nëpërmjet shembujve konkretë.
Kompetenca personale	
- bashkëpunon me të tjerët, pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta, për arritjen e një qëllimi të përbashkët në veprimtaritë në klasë ose në shkollë.	- bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta, për arritjen e një qëllimi të përbashkët në projektet ose veprimtaritë në bazë klase ose shkolle.
Kompetenca qytetare	
- shpreh mendimin duke kërkuar paraprakisht leje nga grupi dhe respekton mendimin e çdo anëtari të grupit.	- shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe vendos për mënyrat e përfundimit të një veprimtarie të përbashkët.
Kompetenca digjitale	
- njeh disa mjete të thjeshta të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit;	- organizon, mbledh dhe shfaq të dhënat e gjetura nga burimet e informacionit elektronik.

3.3. Përshkrimi i kompetencave të lëndës së gjuhës shqipe

Përshkrimi i kompetencave gjuhësore i orienton mësuesit për drejtimit kryesore në të cilat duhet të përqendrohen gjatë zbatimit të programit, në mënyrë që nxënësit t'i zhvillojnë vit pas viti këto kompetenca.

a) Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Nxënësit marrin njohuri, zhvillojnë qëndrime dhe vlera, si dhe zbatojnë aftësi dhe shkathtësi duke dëgjuar tekste të ndryshme. Më konkretisht, nxënësit kuptojnë se sjellja dhe qëndrimet e duhura gjatë të dëgjuarit ndikojnë pozitivisht tek të tjerët. Ata dallojnë disa cilësi të zërit të folësit, si: intonacioni, ritmi, theksi, lartësia e zërit. Gjithashtu, nxënësit tregojnë brendinë, veçojnë idenë kryesore, dallojnë fjalët ose frazat kyç, nxjerrin përfundime, krahasojnë ose klasifikojnë, si dhe bëjnë vlerësime të thjeshta për tekstet që dëgjojnë.

b) Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Nxënësit përdorin drejt gjuhën standarde gjatë folurit; kuptojnë dhe zbatojnë në komunikim karakteristikat e gjuhës së folur; shqiptojnë saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë, me qëllim që të jenë të kuptueshëm dhe interesantë për të tjerët; shoqërojnë të folurin edhe me elemente të komunikimit joverbal; diskutojnë dhe bashkëveprojnë me të tjerët gjatë punës në grup.

c) Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare

Nxënësit lexojnë tekste letrare dhe jo letrare që u përkasin periudhave të ndryshme, tekste të letërsisë klasike dhe bashkëkohore, shqipe dhe botërore, dhe demonstrojnë kuptimin, interpretimin, analizën, vlerësimin dhe gjykimin e këtyre teksteve (të përshtatshme për zhvillimin moshor të nxënësve).

ç) Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Nxënësit shkruajnë për qëllime dhe për lexues të ndryshëm. Ata ndjekin gjatë të shkruarit hapa, si: planifikimi, organizimi i ideve, rishikimi dhe redaktimi. Nxënësit, gjithashtu, respektojnë strukturën, tiparet e tekstit, si dhe zbatojnë rregullat gjuhësore.

d) Përdorimi i drejtë i gjuhës

Që nxënësit të flasin dhe të shkruajnë në mënyrën e duhur, ata duhet të zotërojnë njohuri e të demonstrojnë shkathtësi, vlera dhe qëndrime në lidhje me sistemin gjuhësor të gjuhës shqipe. Kështu, nxënësit dallojnë pjesët e ndryshme të ligjëratës e kategoritë gramatikore të tyre dhe i përdorin në trajtën e duhur gjatë komunikimit; dallojnë llojet e ndryshme të fjalive dhe funksionet e fjalëve në fjali dhe i zbatojnë këto njohuri në komunikimin e përditshëm; përdorin gjuhën standarde, njohin dialektet e pjesë të tjera të leksikut dhe respektojnë shumëllojshmërinë

gjuhësore; kanë njohuri për mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe; dallojnë kuptimet e fjalëve dhe i përdorin për të pasuruar fjalorin e tyre.

3.4. Koha mësimore

Programi plotësues zhvillohet në dy javë mësimore. Në klasat 1-5, lënda e gjuhës shqipe zhvillohet 2 orë mësimore çdo ditë, pra gjithsej **20 orë** për secilën klasë.

3.5. Përmbajtja e programit plotësues sipas klasave

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat për çdo klasë. Ato janë ndarë sipas kompetencave lëndore. Kjo ndarje nuk nënkupton që mësuesit punojnë në mënyrë të veçantë për to, por gjatë çdo ore mësimi punohet për zhvillimin e të gjitha kompetencave, pasi nxënësit çdo orë flasin, dëgjojnë, lexojnë, shkruajnë dhe fitojnë njohuri dhe shkathtësi rreth sistemit gjuhësor.

3.5.1. KLASA E PARË

Rezultatet e të nxënit për kompetencat lëndore	
Nxënësi:	
<ul style="list-style-type: none"> - tregon me fjalët e tij përmbajtjen e një teksti letrar ose të një teksti jo letrar që dëgjon; - flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje ose kur përshkruan diçka etj.; - diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë, bën pyetje dhe jep përgjigje të thjeshta; - merr pjesë në lojë me role; - mëson fjalë të reja, dallon fjalën, fjalinë dhe paragrafin; - lexon rrjedhshëm një tekst të shkurtër; - tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit ose parafrazon tekstin; - jep përshtypjet e veta në lidhje me një tekst të shkurtër letrar (poezi, përralla, tregime, fabula) dhe me një tekst jo letrar; - shkruan tekste të thjeshta sipas modeleve të dhëna. 	
Njohuritë	Shkathtësitë
Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	
Nxënësi dëgjon dhe punon me tekste, si: përralla, fabula, ndodhi personale.	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> - u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit; - tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit (rreth një faqe teksti);

	<ul style="list-style-type: none"> - shpreh përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një fabule, përralle apo ndodhie; - bën gjykime të thjeshta rreth tekstit.
Kompetenca: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	
Nëpërmjet bisedave të ndryshme në klasë, nxënësi merr njohuri për rregullat e thjeshta të të folurit, si: qartësia, lartësia e zërit, intonacioni (<i>si e bëjmë zërin, kur pyesim</i>), pozicioni i trupit gjatë kohës që flasim.	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë; - shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plota, kur bën një kërkesë, pyet, sqaron, kërkon ndjesë, falënderon dhe u përgjigjet pyetjeve; - reciton poezi të shkurtra, të mësuar përmendsh; - merr pjesë në lojë me role (<i>me ndihmën e mësuesit ose të një të rrituri</i>); - pyet, përgjigjet, shpreh mendimet, ndjenjat dhe emocionet e tij, si dhe diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë (kryesisht brenda klasës).
Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare	
<ul style="list-style-type: none"> - Shkronjat e alfabetit (të mëdha e të vogla) dhe tingujt: G, g; Gj, gj; Th, th; C,c; Ç, ç; Nj. Nj; Y,y; Z,z; X,x; Xh, xh; Zh, zh. - Tiparet dalluese të fjalisë (fillimi me shkronjë të madhe dhe shenja e pikësimit në fund). - Studim tekstesh letrare: përralla të shkurtra, fabula, tregime me figura, poezi të thjeshta. - Studim tekstesh joletrare: rregulla të thjeshta praktike. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - emërton shkronjat e alfabetit; - dallon shkronjat e mëdha nga shkronjat e vogla; - përdor lidhjen mes shkronjës dhe tingullit për të lexuar dhe për të kuptuar fjalë të reja; - shqipton drejt tingujt, rrokjet dhe fjalët; - lexon afërsisht 50-70 fjalë në minutë; - identifikon tiparet dalluese të një fjalie: shkronja e madhe në fillim të saj dhe shenja e pikësimit në fund; - pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të; - rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë atë (<i>kur është e nevojshme</i>); - tregon <i>shkurtimisht dhe me fjalë të thjeshta brendinë e tekstit</i>;

	<ul style="list-style-type: none"> - shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon, me ndihmën ose nxitjen e mësuesit; - lexon poezi, përralla, tregime, fabula, gjëegjëza etj.; - përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilat janë personazhet e preferuara; - lexon tekste jo letrare për fëmijë dhe demonstroi të kuptuarin e tyre.
Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	
<ul style="list-style-type: none"> - Shkrimi i shkronjave: G, g; Gj, gj; Th, th; C,c; Ç, ç; Nj. Nj; Y,y; Z,z; X,x; Xh, xh; Zh, zh. - Shkrimi i fjalëve tre- deri katërrokëshe. - Shkrimi i fjalisë dhe vendosja e shenjës së pikësimit në fund të saj. - Përshkrimi i një personazhi sipas një modeli të dhënë. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe shkruan shkronjat e gjuhës shqipe; - tregon me saktësi lidhjen shkronjë-tingull; - respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive; - plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve ose fjalive; - shkruan fjalë me tri - katër rrokje; - kopjon tekste të shkurtra; - shkruan fjalë dhe fjali me të diktuar; - u përgjigjet me shkrim pyetjeve të thjeshta. - pyet për t'u sqaruar rreth tekstit që do të shkruajë; - bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit. - shkruan hyrje dhe mbyllje të tjera të një tregimi ose të një përralle; - përshkruan shokë, miq, të afërm, personazhe, objekte, sende e kafshë të dashura për të; - shkruan tekste të shkurtra (një urim, një kartolinë) duke përdorur një model të thjeshtë.
Vlerat dhe qëndrimet	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi siguri kur flet në klasë dhe në shkollë; - përzgjedh fjalorin e duhur gjatë të folurit (nuk fyen të tjerët, përdor fjalët dhe shprehjet e mirësjelljes); 	

- përfshihet në diskutime, në punë në grup dhe në veprimtari të tjera të klasës;
- tregon interes dhe dëshirë për të lexuar;
- shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të shkruarit;
- vlerëson punët e të tjerëve;
- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.

3.5.2. KLASA E DYTË

Rezultatet e të nxënësve për kompetencat lëndore

Nxënësi:

- tregon me fjalët e tij përmbajtjen ose informacionin kryesor të një teksti letrar ose të një teksti jo letrar që dëgjon;
- flet rrjedhshëm, kuptueshëm dhe me intonacionin e duhur, kur tregon një ngjarje ose kur përshkruan diçka;
- diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë, bën pyetje dhe jep përgjigje të thjeshta;
- merr pjesë në lojë me role;
- përdor strategjitë e duhura për të lexuar tekste të thjeshta, mëson fjalë të reja, dallon fjalën, fjalinë dhe paragrafin;
- lexon me zë një tekst të shkurtër dhe tregon funksionin e pjesëve plotësuese të tekstit (p.sh., fotografi, pikturë etj.);
- tregon brendinë duke respektuar strukturën e tekstit ose parafrazon tekstin;
- jep përshtypjet e veta në lidhje me një tekst të shkurtër letrar dhe me një tekst jo letrar;
- shkruan tekste të thjeshta për të komunikuar idetë e tij tek të tjerët nëpërmjet fjalëve, fjalive etj.;
- zgjedhon folje të rregullta në kohën e tashme, sipas modeleve të dhëna;
- gjen dhe formon fjali me përemra vetorë dhe me numërorë.

Njohuritë

Shkathësitë

Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Nxënësi dëgjon dhe punon me tekste, si: përralla, tregime, ndodhi personale, rregulla praktike etj.

Nxënësi:

- u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit;
- tregon shkurtimisht përmbajtjen e tekstit (rreth një faqe teksti) duke e ilustruar me detaje nga teksti;
- shpreh përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë dëgjimit të një tregimi apo të një përralle;
- lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e

	<p>tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera;</p> <ul style="list-style-type: none"> - bën gjykimet të thjeshta rreth tekstit.
Kompetenca: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	
<p>Nëpërmjet bashkëbisedimeve dhe diskutimeve rreth temave të përshtatshme për moshën e tij, si: <i>natyra përreth, kafshët shtëpiake, qyteti ose fshati im, ngjarjet interesante në jetë, festat lokale, kompjuteri dhe televizori etj.</i>, nxënësi merr njohuri për rregullat e të folurit gjatë punës në grupe të vogla.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë; - shprehet saktë, kuptueshëm dhe me fjali të plotë, kur bën një kërkesë, pyet, sqaron, kërkon ndjesë, falënderon dhe u përgjigjet pyetjeve; - reciton vjersha të shkurtra, të mësuara përmendsh; - shpreh emocione dhe ndjesi të ndryshme me anë të pantomimës ose ndërton histori mbi bazën e ilustrimeve dhe të figurave të dhëna; - merr pjesë në lojë me role dhe shpreh opinionet e tij rreth interpretimit të shokëve dhe të shoqeve të klasës; - diskuton në grupe të vogla për tema që i interesojnë (kryesisht brenda klasës).
Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare	
<p>Studim tekstesh letrare: përralla, tregime, poezi.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohuri të thjeshta e të përgjithshme për tiparet e përrallave, tregimeve dhe poezive (p.sh., <i>shkruhen në vargje, strofa</i>). - Njohuri për elementet e teksteve, si: paragrafi, rreshti, strofa, vargu. <p>Studim tekstesh jo letrare: revista për fëmijë.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shqipton drejt tingujt, rrokjet dhe fjalët; - lexon afërsisht 70- 90 fjalë në minutë; - parashikon rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli, ilustrimet dhe fjalët kyç të tekstit; - pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të; - rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë atë (<i>kur është e nevojshme</i>); - tregon <i>shkurtimisht dhe me fjalë të thjeshta brendinë e tekstit</i>; - shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon; - lexon poezi, përralla, tregime etj.; - përcakton dy-tri tipare të përrallave, tregimeve, poezive;

	<ul style="list-style-type: none"> - përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilat janë personazhet e preferuara; - dallon elemente të tekstit, të tilla si: paragrafi, rreshti, strofa, vargu; - tregon se si ndikojnë ilustrimet për të kuptuar më mirë tekstin; - lexon tekste të thjeshta jo letrare për fëmijë; - veçon disa elemente të teksteve, si: titujt, tekstet dhe ilustrimet; - komenton ilustrimin e një teksti.
Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	
<ul style="list-style-type: none"> - Dikttime. - Rrëfimi i një historie personale (gjysmë faqe). - Shkrimi i tregimeve të thjeshta nisur nga disa ilustrime. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - respekton, kur shkruan, hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive; - plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve ose fjalive; - shkruan fjalë me tri - katër rrokje; - u përgjigjet me shkrim pyetjeve të thjeshta. - pyet për t'u sqaruar rreth tekstit që do të shkruajë; - studion modele të gatshme të punëve me shkrim; - bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësuesit; - shkruan tregime të thjeshta nisur nga figurat e dhëna; - shkruan hyrje dhe mbyllje të tjera të një tregimi ose përralle; - rrëfen histori e përvoja personale duke u ndihmuar nga pyetjet: <i>Kush? Cili? Çfarë? Si? Kur? Ku?</i>; - shkruan tekste të shkurtra jo letrare.
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës	
<p>a) Morfologji Folja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohuri të thjeshta për foljen. - Koha e kryerjes së një veprimi, nisur 	<p>Nxënësi:</p> <p>a) Morfologji Folja</p>

<p>nga koncepti kohë: <i>dje-sot-nesër</i>.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zgjedhimi i foljeve <i>kam</i> dhe <i>jam</i> në kohën e tashme. - Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e tashme, sipas modeleve të dhëna. <p>Përemri</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përemri vetor. <p>Numërori</p> <ul style="list-style-type: none"> - Numërori. <p>b) Drejtshkrim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkrimi i numërorëve nga 1 deri në 20. <p>c) Leksikologji dhe semantikë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sinonimet (<i>fjalë me kuptim të afërt ose të njëjtë</i>). - Antonimet (<i>fjalë me kuptim të kundërt</i>). 	<ul style="list-style-type: none"> - dallon fjalët që tregojnë veprim (me ndihmën e mësuesit); - dallon kohën e kryerjes së një veprimi, nisur nga koncepti kohë: <i>dje-sot-nesër</i>; - zgjedhon folje të rregullta në kohën e tashme, sipas modeleve të dhëna; - zgjedhon foljet <i>kam</i> dhe <i>jam</i> në kohën e tashme. <p>Përemri</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon përemrat vetorë: <i>unë, ti, ai/ajo, ne, ju, ata/ato</i>; - gjen në fjali përemrat vetorë; - ndërton fjali me përemra vetorë. <p>Numërori</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon numërorët nga 1 deri në 20 si fjalë që tregojnë sasi; - formon fjali me numërorë. <p>a) Drejtshkrim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan me fjalë numërorët nga 1 deri në 20. <p>b) Leksikologji dhe semantikë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zëvendëson, në një tekst, disa fjalë me sinonimet e tyre; - gjen fjalë antonimike për një grup fjalësh të dhëna (<i>Gjeni fjalë me kuptim të kundërt.</i>).
Vlerat dhe qëndrimet	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi siguri kur flet në klasë dhe jashtë saj; - përzgjedh fjalorin e duhur gjatë të folurit (nuk fyen të tjerët, përdor fjalët dhe shprehjet e mirësjelljes); - shoqëron të folurin me shprehjen e duhur të fytyrës dhe me gjeste të përshtatshme; - përfshihet në diskutime, në punë në grup dhe në veprimtari të tjera të klasës; - tregon interes dhe dëshirë për të lexuar; - shfaq besim në forcat e veta për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit; - ndan me të tjerët përvojat e tij rreth leximit; - pranon idetë e të tjerëve për tekstet që lexojnë, duke treguar respekt ndaj tyre; - shfaq besim, vullnet dhe shpirt krijues gjatë procesit të shkruarit; - vlerëson punët e të tjerëve; 	

- bashkëpunon në grup për kryerjen e një detyre.

3.5.3. KLASA E TRETË

<p>Rezultatet e të nxënit për kompetencat lëndore</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton një tekst që dëgjon; - komunikon me të tjerët për përmbajtjen e teksteve; - merr pjesë në diskutime për tema të përshtatshme për moshën e tij; - shfaq prirjet e veta në lojërat e thjeshta skenike; - përdor strategjitë e të lexuarit për të kuptuar tekste letrare apo jo letrare; - dallon idetë kryesore në tekste letrare, si: <i>poezi, tregime, përralla</i> etj.; - dallon dhe analizon idetë kryesore të tekstit jo letrar; - shkruan tekste duke u përqendruar në temën që do të trajtojë; - identifikon, me ndihmën e mësuesit, elementet që kanë nevojë për përmirësime në punët e tij dhe i rregullon ato; - dallon kategoritë gramatikore kryesore të foljes dhe të përemrit. 	
Njohuritë	Shkathhtësitë
Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	
<p>Nxënësi dëgjon dhe punon (tregon përmbajtjen, ndan në pjesë tekstin, jep mendimet e tij) me tekste, si: përralla, rrëfime ose ndodhi personale, tregime, poezi, udhëzime ose porosi të thjeshta.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tregon njohuritë paraprake rreth tekstit që dëgjon; - përcakton qëllimin që ka, kur dëgjon një tekst; - u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit; - dallon hyrjen, zhvillimin dhe fundin e një historie, përralle, tregimi etj.; - përmbledh përmbajtjen e tekstit duke e ilustruar me detaje, shembuj ose ilustrime nga teksti; - parashikon se çfarë do të ndodhë në vijim, kur dëgjon pjesë-pjesë një rrëfim (dëgjim i drejtuar); - jep gjykime të thjeshta rreth tekstit.
Kompetenca: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	
<ul style="list-style-type: none"> - Diskutime për tema të ndryshme. - Teknikat e recitimit. 	<p>Nxënësi:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - flet duke përdorur cilësitë e duhura të zërit, si: theksi, lartësia e zërit, intonacioni etj.; - shpreh mendimet dhe ndjesitë e tij me një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme; - reciton me ndjenjë pjesë të mësuara përmendsh; - përdor mirë gjuhën standarde gjatë të folurit; - merr pjesë në diskutime për tema të ndryshme.
Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare	
<p>Studim tekstesh letrare: poezi të thjeshta, gjëgjëza, përralla, tregime etj.</p> <p>Studim tekstesh jo letrare: revista për fëmijë, udhëzime të thjeshta etj.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon rrjedhshëm tekstin; - parashikon se çfarë do të ndodhë në tekst duke u bazuar në atë që ka lexuar më parë (<i>lexim i drejtuar</i>); - kërkon dhe gjen në fjalor kuptimin e fjalëve të panjohura që lexon; - u përgjigjet pyetjeve të mësuesit rreth brendisë së tekstit; - tregon brendinë e pjesës që lexon; - përmbledh idetë kryesore duke i ilustruar me fragmente dhe detaje nga teksti; - lidh idetë dhe informacionin e tekstit me njohuritë, përvojën dhe leximet e mëparshme ose dukuri të jetës së përditshme; - gjykon me argumente të thjeshta idetë dhe informacionin e tekstit; - lexon tekste letrare, si: <i>poezi, tregime, përralla</i>; - u përgjigjet pyetjeve <i>Kush? Çfarë? Kur? Ku? Pse?</i> në lidhje me ngjarjet që ndodhin në tregim, përrallë etj.; - lexon tekste jo letrare <i>për fëmijë</i>; - përmbledh shkurtimisht informacionin e një teksti jo letrar.
Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	
<ul style="list-style-type: none"> - Dikttime. - Tregim për shokun/shoqen. 	<p>Nxënësi:</p>

<ul style="list-style-type: none"> - Rrëfime në vetën e parë të ngjarjeve të jetuara, interesante ose të veçanta. 	<ul style="list-style-type: none"> - shkruan duke u përqendruar në temën që do të trajtojë dhe lidh logjikisht fjalitë në paragraf dhe paragrafët mes tyre; - mbështet idetë me shembuj të ndryshëm; - zbaton rregullat e drejtshkrimit gjatë të shkruarit; - rishikon dhe përmirëson punët me shkrim për të dhënë më qartë mendimet dhe për të përmirësuar përmbajtjen; - rishikon tekstin që shkruan për të gjetur fjalët, shprehjet ose fjalitë e papërshtatshme dhe për t'i plotësuar ato me të tjera; - korigjon gabimet drejtshkrimore; - përshekruan një person duke pasqyruar ndjenjat, mendimet dhe paraqitjen e jashtme të tyre; - rrëfen ngjarje, shpreh ndjenja, përcjell ide rreth botës reale dhe asaj imagjinare.
--	--

Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës

<p>a) Morfologji</p> <p>Folja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Folja, çfarë tregon (njohuri të përgjithshme). - Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e tashme. - Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e ardhme. - Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e pakryer. <p>Përemri</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përemri vetor. <p>Numërori</p> <ul style="list-style-type: none"> - Numërori si fjalë që tregon sasi. <p>b) Drejtshkrim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Drejtshkrimi i foljeve të rregullta në kohën e tashme, në kohën e ardhme dhe në kohën e pakryer. 	<p>a) Morfologji</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon përemrat vetorë; - zgjedhon foljet e rregullta në kohën e tashme, në kohën e pakryer dhe në kohën e ardhme; - dallon dhe përdor në fjali përemrin vetor; - dallon dhe përdor në fjali numërorin. <p>b) Drejtshkrim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan saktë foljet në kohën e tashme, në kohën e pakryer dhe në kohën e ardhme.
--	---

Vlerat dhe qëndrimet

Nxënësi:

- demonstroi vullnet gjatë kryerjes së detyrave;
- merr pjesë në diskutime në grup dhe bashkëpunon me të tjerët;
- shfaq me siguri dhe me besim në vetvete mendimet, përvojat dhe argumentet e tij;
- është i motivuar për të lexuar për kënaqësi dhe për informacion;
- është i vëmendshëm gjatë të lexuarit;
- respekton dhe pranon mendimin e tjetrit;
- shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit;
- punon në mënyrë të pavarur;
- respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
- vlerëson punët e të tjerëve.

3.5.4. KLASA E KATËRT

Rezultatet e të nxënit për kompetencat lëndore

Nxënësi:

- kupton një tekst që dëgjon;
- komunikon me të tjerët për përmbajtjen dhe për qëllimin e teksteve;
- veçon informacionin kryesor të bisedave të thjeshta ose të tregimeve dhe diskuton rreth tyre;
- merr pjesë në diskutime për tema të përshtatshme për moshën e tij;
- shfaq prirjet e veta në lojërat e thjeshta skenike;
- dallon temën dhe idetë kryesore në tekste letrare;
- analizon elemente të thjeshta në një tekst, si: subjekti, personazhet, mjedisi ose hapësira ku zhvillohen ngjarjet etj.;
- dallon dhe analizon temën, idetë dhe strukturën e një teksti jo letrar;
- shkruan tekste duke u përqendruar në temën që do të trajtojë duke lidhur logjikisht fjalitë në paragraf dhe paragrafët mes tyre;
- identifikon, me ndihmën e mësuesit, elementet që kanë nevojë për përmirësime në punët e tij dhe i rregullon ato;
- dallon dhe përdor drejt gjymtyrët kryesore të fjalisë;
- dallon kategoritë gramatikore kryesore të foljes;
- dallon dhe përdor sinonimet dhe antonimet.

Njohuritë

Shkathtësitë

Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme

Nxënësi dëgjon dhe punon (*tregon përmbajtjen, analizon, jep gjykime të thjeshta*) me tekste të cilat janë të përshtatshme për moshën e tij, si: poezi,

Nxënësi:

- tregon njohuritë paraprake rreth tekstit që dëgjon;

<p>përralla, fabula, tregime, rrëfime ose ngjarje personale, informacione të thjeshta për sportin, artin, lojërat etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit; - dallon hyrjen, zhvillimin dhe fundin e një historie, përralle, tregimi etj.; - përmbledh përmbajtjen e tekstit duke e ilustruar me detaje, shembuj ose ilustrime nga teksti; - veçon detajet dhe çështjet kryesore të tekstit që dëgjon; - parashikon se çfarë do të ndodhë në vijim, kur dëgjon pjesë-pjesë një rrëfim (dëgjim i drejtuar); - lidh përmbajtjen e një teksti që dëgjon me atë të librave, filmave etj., që trajtojnë të njëjtën temë; - jep gjykime të thjeshta rreth tekstit.
<p>Kompetenca: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar</p>	
<p>Duke folur për tema të ndryshme, nxënësi merr njohuri për rrjedhshmërinë gjatë të folurit dhe për rregullat e thjeshta për zgjedhjen e fjalëve dhe të frazave të duhura për të respektuar të tjerët.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - flet duke përdorur cilësitë e duhura të zërit, si: theksi, lartësia e zërit, intonacioni etj.; - vlerëson rrjedhshmërinë gjatë të folurit; - shpreh mendimet dhe ndjesitë e tij me një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme; - bën një prezantim të thjeshtë për të treguar një përvojë të tijën; - reciton me ndjenjë pjesë të mësuara përmendsh; - merr pjesë në diskutime, prezantime, shfaqje etj., për tema të ndryshme; - mbështet dhe vlerëson mendimet dhe idetë e të tjerëve gjatë diskutimeve dhe bashkëpunimit në grup; - njeh dhe zbaton rregullat e thjeshta për zgjedhjen e fjalëve dhe të frazave të duhura për të respektuar të tjerët.
<p>Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare</p>	
<p>Studim tekstesh letrare: poezi të thjeshta, fabula, përralla, tregime, gjëgjëza etj.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon rrjedhshëm tekstin;

<p>Nxënësi merr njohuritë të thjeshta për tiparet kryesore të teksteve të mësipërme.</p> <p>Studim tekstesh jo letrare: shkrime në revista dhe në gazeta për fëmijë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - parashikon se çfarë do të ndodhë në tekst duke u bazuar në atë që ka lexuar më parë (<i>lexim i drejtuar</i>); - kërkon dhe gjen në fjalor kuptimin e fjalëve të panjohura që lexon; - u përgjigjet pyetjeve të mësuesit rreth brendisë së tekstit; - tregon brendinë e pjesës që lexon; - përmbledh idetë kryesore duke i ilustruar me fragmente dhe detaje nga teksti; - lidh idetë dhe informacionin e tekstit me njohuritë, përvojën dhe leximet e mëparshme ose dukuri të jetës së përditshme; - gjykon me argumente të thjeshta idetë dhe informacionin e tekstit; - krahason në një tekst dy ose më shumë ide, koncepte, detaje etj.; - lexon tekste të ndryshme letrare; - u përgjigjet pyetjeve <i>Kush? Çfarë? Kur? Ku? Pse?</i> në lidhje me ngjarjet që ndodhin në tregim, përrallë, fabul etj.; - rilexon dhe tregon pjesën që i pëlqen më shumë dhe është më e këndshme për të, si dhe argumenton pëlqimin e tij; - analizon personazhet duke u mbështetur në dialogët, përshkrimet dhe veprimet e tyre; - krahason tregimin me përrallën dhe me fabulën (tiparet kryesore të tyre); - diskuton me të tjerët dhe jep opinionet e tij për librat që lexon për leximet jashtë klase dhe për lexime të tjera. - lexon tekste jo letrare; - dallon idetë kryesore në tekstet jo letrare; - analizon strukturën e një teksti jo letrar.
<p>Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale</p>	
<ul style="list-style-type: none"> - Dikttime. - Përshkrime të shokëve, artistëve ose sportistëve të preferuar etj. 	<p>Nxënësi:</p>

<ul style="list-style-type: none"> - Rrëfime ngjarjesh rreth botës reale dhe imagjinare, si p.sh.: për pushimet, për librat, për universin etj. - Përshkrime të thjeshta personazhesh. 	<ul style="list-style-type: none"> - shkruan duke u përqendruar në temën që do të trajtojë dhe lidh logjikisht fjalitë në paragraf dhe paragrafët mes tyre; - mbështet idetë me shembuj të ndryshëm; - shton, në një tekst, një dialog mes personazheve ose një ndodhi të re, një paragraf; - përdor mirë gjuhën standarde; - zbaton rregullat e drejtshkrimit gjatë të shkruarit; - rishikon dhe përmirëson punët me shkrim për të dhënë më qartë mendimet dhe për të përmirësuar përmbajtjen; - rishikon tekstin që shkruan për të gjetur fjalët, shprehjet ose fjalitë e papërshtatshme dhe për t'i plotësuar ato me të tjera; - korrigjon gabimet drejtshkrimore; - përshkruan personazhet duke pasqyruar ndjenjat, mendimet dhe paraqitjen e jashtme të tyre; - rrëfen ngjarje, shpreh ndjenja, përcjell ide rreth botës reale dhe asaj imagjinare; - shkruan një hyrje ose një mbyllje ndryshe të një tregimi, përralle etj.
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës	
<p>a) Sintaksë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Grupet kryesore të fjalëve në fjali. Veprime me grupet kryesore të fjalëve në fjali. - Kryefjala, njohuri të përgjithshme. - Kallëzuesi, njohuri të përgjithshme. - Përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën. <p>b) Morfologji Folja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zgjedhimi i foljeve <i>kam</i> dhe <i>jam</i> në kohën e tashme, të pakryer dhe të kryer të thjeshtë. 	<p>a) Sintaksë Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - bën dallimin mes një teksti dhe një grupi fjalish që nuk kanë lidhje kuptimore; - heq, shton ose zhvendos fjalë në fjali, pa e prishur kuptimin e saj; - dallon kryefjalën; - dallon kallëzuesin. <p>b) Morfologji Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjedhon në kohën e tashme, në kohën e kryer të thjeshtë, në kohën e pakryer dhe në kohën e ardhme foljet <i>kam</i> dhe <i>jam</i>;

<ul style="list-style-type: none"> - Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e tashme. - Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e pakryer. - Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e kryer të thjeshtë, në mënyrën dëftore. - Zgjedhimi i foljeve të rregullta në kohën e ardhme. <p>c) Leksikologji dhe semantikë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sinonimet dhe antonimet. - Fjalët me shumë kuptime (njohuri të përgjithshme). 	<ul style="list-style-type: none"> - zgjedhon foljet e rregullta në kohën e tashme, në kohën e kryer të thjeshtë, në kohën e pakryer dhe në kohën e ardhme; - përdor saktë në fjali foljet e rregullta në kohën e tashme, në kohën e kryer të thjeshtë, në kohën e pakryer dhe në kohën e ardhme. <p>c) Leksikologji dhe semantikë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton kuptimet e fjalës në kontekstin e dhënë; - krijon çifte sinonimie dhe antonimie; - dallon dhe përdor në fjali sinonimet, antonimet dhe homonimet, për të përmirësuar gjuhën e folur dhe të shkruar.
Vlerat dhe qëndrimet	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi vullnet gjatë kryerjes së detyrave; - merr pjesë në diskutime në grup dhe bashkëpunon me të tjerët; - shfaq me siguri dhe me besim në vetvete mendimet, përvojat dhe argumentet e tij; - është i motivuar për të lexuar për kënaqësi dhe për informacion; - është i vëmendshëm gjatë të lexuarit; - respekton dhe pranon mendimin e tjetrit; - shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të të shkruarit; - punon në mënyrë të pavarur; - respekton rregullat drejtshkrimore gjatë të shkruarit; - vlerëson punët e të tjerëve. 	

3.5.5. KLASA E PESTË

<p>Rezultatet e të nxënit për kompetencat lëndore</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - komunikon me të tjerët për përmbajtjen dhe për qëllimin e teksteve që dëgjon;
--

<ul style="list-style-type: none"> - veçon informacionin kryesor të bisedave të thjeshta ose të tregimeve dhe diskuton rreth tyre; - merr pjesë në diskutime për tema të përshtatshme për moshën e tij; - përgatit materiale për organizimin e veprimtarive të ndryshme në klasë; - shfaq prirjet e veta në lojërat e thjeshta skenike; - dallon temën, mesazhin dhe idetë kryesore në tekste letrare, si: <i>poezi, fabula, tregime, novela, përralla</i> etj.; - analizon elemente të thjeshta në një tekst, si: subjekti, personazhet, mjedisi ose hapësira ku zhvillohen ngjarjet etj.; - dallon dhe analizon temën, idetë dhe strukturën e tekstit jo letrar (<i>udhëzim, njoftim, reklamë</i> etj.); - shkruan tekste duke u përqendruar në temën që do të trajtojë duke lidhur logjikisht fjalitë në paragraf dhe paragrafët mes tyre; - shkruan tekste për qëllime dhe lexues të ndryshëm; - dallon dhe përdor drejt gjymtyrët kryesore dhe gjymtyrët e dyta (<i>përcaktorin</i>) të fjalisë; - dallon kategoritë gramatikore kryesore të foljes dhe të përemrit; - dallon dhe përdor sinonimet, antonimet dhe homonimet. 	
Njohuritë	Shkathësitë
Kompetenca: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	
<p>Nxënësi demonstroi aftësitë e të dëgjuarit në tekste letrare dhe në tekste jo letrare.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tregon njohuritë paraprake rreth tekstit që dëgjon; - përcakton qëllimin që ka, kur dëgjon një tekst; - u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit; - dallon hyrjen, zhvillimin dhe fundin e një historie, përralle, tregimi etj.; - përmbledh përmbajtjen e tekstit duke e ilustruar me detaje, shembuj ose ilustrime nga teksti; - veçon detajet dhe çështjet kryesore të tekstit që dëgjon; - pyet rreth informacioneve ose ideve që dëgjon nga një prezantim, në mënyrë që të sqarohet dhe të kuptojë tekstin; - parashikon se çfarë do të ndodhë në vijim, kur dëgjon pjesë-pjesë një rrëfim (dëgjim i drejtuar);

	<ul style="list-style-type: none"> - mban shënime për çështjet kryesore; - jep gjykime të thjeshta rreth tekstit; - formulon mesazhin e një teksti.
Kompetenca: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	
<p>Nxënësi diskuton për tema të ndryshme që janë të përshtatshme për moshën e tij. Gjatë këtyre diskutimeve, nxënësi merr njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rëndësia e përdorimit të gjuhës standarde gjatë të folurit. - Përgatitja e një prezantimi të thjeshtë. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - flet duke përdorur cilësitë e duhura të zërit, si: theksi, lartësia e zërit, intonacioni etj.; - vlerëson rrjedhshmërinë gjatë të folurit; - përcakton qëllimin që ka, kur flet ose bashkëbisedon me të tjerët; - shpreh mendimet dhe ndjesitë e tij me një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme; - bën një prezantim të thjeshtë për të treguar një përvojë të tijën, duke e shoqëruar prezantimin me mjete pamore, si: <i>harta, fotografi etj.</i>; - reciton me ndjenjë pjesë të mësuara përmendsh; - përdor mirë gjuhën standarde gjatë të folurit; - merr pjesë në diskutime, prezantime, shfaqje etj., për tema të ndryshme; - mbështet dhe vlerëson mendimet dhe idetë e të tjerëve gjatë diskutimeve dhe bashkëpunimit në grup (çift, grupe të vogla, grupe të mëdha).
Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare	
<p>Studim tekstesh letrare: poezi, këngë popullore, fabula, tregime, novela, legjenda, përralla, romane për fëmijë, tekste të thjeshta dramatike.</p> <p>Nxënësi merr njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tema ose çështjet kryesore. - Analizë e thjeshtë e subjektit, mjedisit dhe kohës në një tekst. - Analizë personazhesh duke u bazuar në fjalët, përshkrimet dhe veprimet e tyre. - Tiparet e një teksti të thjeshtë dramatik: personazhet, dialogët, 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përzgjedh tekstin që lexon në varësi të qëllimit që ka; - lexon rrjedhshëm tekstin; - përdor disa strategji për të kuptuar tekstin (<i>para, gjatë dhe pas leximit</i>), si p.sh.: <i>aktivizon njohuritë e mëparshme nëpërmjet një diskutimi në grup; i rikthehet leximit të tekstit derisa ta kuptojë atë; bën pyetje për çështje që nuk i kupton në tekst etj.</i>; - parashikon se çfarë do të ndodhë në tekst duke u bazuar në atë që ka lexuar më parë (<i>lexim i drejtuar</i>);

<p>monologët, didaskalitë.</p> <p>Studim tekstesh jo letrare: Tipare të thjeshta të teksteve jo letrare.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - u përgjigjet pyetjeve të mësuesit rreth brendisë së tekstit; - tregon brendinë e pjesës që lexon; - përmbledh idetë kryesore duke i ilustruar me fragmente dhe detaje nga teksti; - lidh idetë dhe informacionin e tekstit me njohuritë, përvojën dhe leximet e mëparshme ose dukuri të jetës së përditshme; - gjykon me argumente të thjeshta idetë dhe informacionin e tekstit; - krahason në një tekst dy ose më shumë ide, koncepte, detaje etj.; - dallon disa elemente të formës dhe të përmbajtjes së teksteve dhe sqaron funksionin e tyre; - lexon tekste të ndryshme letrare; - u përgjigjet pyetjeve <i>Kush? Çfarë? Kur? Ku? Pse?</i> në lidhje me ngjarjet që ndodhin në një tekst letrar; - dallon temat ose idetë kryesore në tekstet letrare (poezi, prozë ose dramë); - analizon subjektin dhe mjedisin ose hapësirën ku zhvillohen ngjarjet në një tekst; - analizon personazhet duke u mbështetur në dialogët, përshkrimet dhe veprimet e tyre; - dallon disa elemente kryesore të tekstit dramatik, si: skenat, grupin e personazheve, fjalët e personazheve, didaskalitë; - lexon tekste të ndryshme jo letrare; - dallon temën ose idetë kryesore në tekstet jo letrare; - analizon strukturën e një teksti jo letrar.
<p>Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale</p>	
<ul style="list-style-type: none"> - Dikttime. - Përshkrimi i ndjenjave të përjetuara gjatë lojës. - Intervista të thjeshta drejtuar një të 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton qëllimin dhe temën (me ndihmën e mësuesit) për të realizuar në mënyrën dhe formën e duhur punën me shkrim;

<p>afërmi, si: gjyshes, shokut, mësuesit etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - shkruan duke u përqendruar në temën që do të trajtojë dhe lidh logjikisht fjalitë në paragraf dhe paragrafët mes tyre; - mbështet idetë me shembuj të ndryshëm; - shton në një tekst, një dialog mes personazheve ose një ndodhi të re, një paragraf; - përdor mirë gjuhën standarde; - zbaton rregullat e drejtshkrimit gjatë të shkruarit; - rishikon dhe përmirëson punët me shkrim për të dhënë më qartë mendimet dhe për të përmirësuar përmbajtjen; - rishikon tekstin që shkruan për të gjetur fjalët, shprehjet ose fjalitë e papërshtatshme dhe për t'i plotësuar ato me të tjera; - korrigjon gabimet drejtshkrimore; - përshkruan personazhet duke pasqyruar ndjenjat, mendimet dhe paraqitjen e jashtme të tyre; - rrëfen ngjarje, shpreh ndjenja, përcjell ide rreth botës reale dhe asaj imagjinare; - shkruan një hyrje ose një mbyllje ndryshe të një tregimi, përralle etj.; - shkruan një intervistë të shkurtër.
<p>Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës</p>	
<p>a) Sintaksë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kryefjala, me çfarë është shprehur. - Kallëzuesi, me çfarë është shprehur. - Përcaktori, me çfarë është shprehur. 	<p>a) Sintaksë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon kryefjalën e shprehur me emër, përemër, numëror etj.; - formon fjali ku kryefjala të jetë e shprehur me emër, përemër, numëror etj.; - dallon kallëzuesin dhe tregon me çfarë është shprehur; - dallon përcaktorin dhe tregon me çfarë është shprehur; - formon fjali me përcaktorë të ndryshëm. <p>b) Morfologji</p> <p>Nxënësi:</p>

<p>b) Morfologji</p> <p>Përemri</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përemri pronor. - Përemri pyetës (<i>Kush? Cili? Çfarë Ç'?</i> Sa?). - Përemri dëftor. <p>Folja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zgjedhimi i foljeve: <i>marr, dal, jap</i> dhe <i>shoh</i>, në kohën e tashme, në kohën e kryer të thjeshtë dhe në kohën e pakryer, në mënyrën dëftore. <p>c) Drejtshkrim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkrimi i datave. 	<ul style="list-style-type: none"> - dallon përemrat pronorë; - dallon dhe përdor përemrat pyetës (<i>Kush? Cili? Çfarë? Ç'?</i> Sa?); - gjen dhe përdor në fjali përemrin dëftor; - zgjedhon në kohën e tashme, në kohën e kryer të thjeshtë dhe në kohën e pakryer foljet <i>marr, dal, jap</i> dhe <i>shoh</i>. <p>c) Drejtshkrim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan drejt datat.
Vlerat dhe qëndrimet	
<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi vullnet gjatë kryerjes së detyrave; - shfaq empati (ndjeshmëri) ndaj të tjerëve; - merr pjesë në diskutime në grup duke pyetur, duke u përgjigjur dhe duke bashkëpunuar me të tjerët; - shfaq me siguri dhe me besim në vetvete mendimet, përvojat dhe argumentet e tij; - është i motivuar për të lexuar për kënaqësi dhe për informacion; - shfaq besim dhe vullnet gjatë procesit të shkruarit; - demonstroi imagjinatë dhe shpirt krijues gjatë të shkruarit; - punon në mënyrë të pavarur; - vlerëson punët e të tjerëve. 	

4. Udhëzime metodologjike për zbatimin e programit plotësues në gjuhën shqipe

Metodat e të nxënësve janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një proces mësimor efektiv. Përdorimi i tyre do të shërbejë për zhvillimin gjuhësor të nxënësve. Gjatë zbatimit të programit plotësues mësuesit duhet të përdorin metoda, teknika dhe strategji të ndryshme mësimore, me qëllim që nxënësit të jetë në qendër të procesit mësimor. Metoda, strategji dhe teknika, të tilla si: *diskutim për njohuritë paraprake, kubimi, diagrami piramidial, leximi i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprakë, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditarët e të nxënësve, pyetja sjell pyetjen, stuhi mendimi, lojë me role etj.*, shërbejnë si nxitje për

nxënësit në procesin e të nxënës dhe si garanci për rezultate të mira. Procesi mësimor duhet të zhvillohet në një ambient miqësor, të ketë rrjedhshmëri dhe cilësi të lartë, të jetë i strukturuar, i planifikuar me kujdes dhe i orientuar drejt lojës.

Programi plotësues i gjuhës shqipe përqendrohet kryesisht në njohuritë dhe aftësitë kryesore të lexim-shkrimit. Mësuesit duhet të përdorin strategji të ndryshme mësimore që të zhvillojnë rrjedhshmërinë në lexim dhe aftësitë e lexim-shkrimit fillestar.

Programi plotësues *nuk ka vlerësime të nxënësve*, por me anë të metodave dhe teknikave të përdorura gjatë procesit të mësimdhënie –nxënies, mësuesi nxit përparimin e nxënësit. Në përfundim të zbatimit të programit plotësues, mësuesi diskuton me mësuesit e vitit të ardhshëm shkollor në lidhje me arritjet dhe nevojat për përmirësim të nxënësve.

5. PROGRAMI PLOTËSUES PËR LËNDËN E MATEMATIKËS

Matematika është shkenca, gjuha universale e së cilës ndihmon nxënësin të kuptojë dhe të veprojë në realitetin që jeton. Kjo e bën atë të japë një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin intelektual të nxënësit dhe për formimin e identitetit të tij. Zotërimi i saj është vlerë e madhe për integrimin në shoqëri duke mundësuar zhvillimin e personalitetit të nxënësit, zhvillimin e aftësive të tij për të menduar në mënyrë kritike dhe për të punuar i pavarur e sistematikisht.

Megjithëse zbatimet e saj janë nga më të ndryshmet, ato nuk mund të kuptohen pa marrjen e disa njohurive themelore të tematikave të saj, pasi këto e bëjnë të vetëdijshëm nxënësin për rolin e matematikës në jetën e përditshme, duke zgjeruar botëkuptimin e tij. Situatat e ndryshme që mund të shqyrtohen me matematikën tregojnë se sa shumë lidhet ajo me fushat e tjera. Me anë të matematikës, nxënësi mund të interpretojë sasi të duke përdorur numrat dhe algjebren, të interpretojë format, hapësirën dhe njësitë duke përdorur gjeometrinë dhe matjet, të interpretojë fenomene të rastit duke përdorur statistikën dhe probabilitetin.

5.1. Qëllimi i programit plotësues të matematikës

Programi plotësues i matematikës ka për qëllim të pajisë nxënësit me modelet e të menduarit matematikor, me idetë bazë dhe strukturat matematikore, si dhe t'u zhvillojë atyre aftësitë llogaritëse dhe të zgjidhjes së problemeve në jetën e përditshme. Gjatë zbatimit të programit plotësues të matematikës, nxënësi:

- zhvillon bazat e të menduarit matematikor;

- formulon koncepte matematikore nëpërmjet përvojave empirike;
- komunikon dhe zbavitet duke zgjidhur problema;
- mëson të argumentojë, me shkrim dhe me gojë, përgjigjet e tij duke u bazuar në ilustrime dhe mjete konkrete;
- zbulon ngjashmëritë, ndryshimet, rregullsitë dhe marrëdhëniet shkak - pasojë ndërmjet dukurive;
- praktikohet në vëzhgime të situatave problemore që kanë lidhje me mjedisin e tyre të përditshëm;
- zhvillon të menduarit matematikor;
- hedh themelet e modelimeve matematikore;
- përforcon veprimet bazë me numra dhe konceptin e numrit;
- kupton konceptet matematikore nëpërmjet hetimeve;
- zgjidh problema matematike;
- argumenton veprimet dhe përfundimet e tyre dhe ia paraqet të tjerëve;
- përdor rregulla dhe ndjek udhëzime;
- edukohet të punojë në grup;
- paraqet situata matematikore në mënyra të ndryshme;
- ndihet i suksesshëm në matematikë.

5.2. Lidhja e kompetencave kyç me kompetencat matematikore

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyç nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e tyre me kompetencat e lëndës së matematikës. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat e të nxënies, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme për procesin e të nxënies. Organizimi i mësimi të matematikës me bazë kompetencat siguron zhvendosjen e fokusit të nxënies nga përmbajtja lëndore (mësuesi në qendër) në atë që nxënësit kanë nevojë të dinë dhe të bëjnë me efikasitet në situata të ndryshme (nxënësi në qendër).

Rezultatet kryesore sipas kompetencave kyç që realizohen nëpërmjet lëndës së matematikës për programin plotësues përmbledhen si më poshtë:

Tabela 1. Kompetencat kyç për programin plotësues

Klasat 1-2 Nxënësi:	Klasat 3-5 Nxënësi:
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit	
<ul style="list-style-type: none"> paraqet të paktën një mendim për një detyrë të caktuar gjatë diskutimit në grup. 	<ul style="list-style-type: none"> dëgjon me vëmendje prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim me pyetje, komente apo sqarime.
Kompetenca e të menduarit	
<ul style="list-style-type: none"> gjen veçoritë e një objekti, të dhënë, ndan dhe krahason më pas në grup gjetjet e veta; sqaron me anë të të folurit hapat e zgjidhjes së një problemi të thjeshtë matematikor me të cilin ballafaqohet në një situatë jetësore. 	<ul style="list-style-type: none"> klasifikon objekte duke shprehur mendimin e tij; zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë në matematikë, duke dhënë shembuj nga jeta e përditshme për situata të ngjashme.
Kompetenca e të nxënit	
<ul style="list-style-type: none"> përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjtë, ngjyrat, numratorin etj., për kryerjen e një detyre të caktuar dhe arsyeton zgjedhjen që ka bërë; parashtron pyetje dhe përgjigjet në pyetjet për temën /problemin/detyrën e dhënë në njërin nga format e të shprehurit; zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes; identifikon njohuritë që ka, të cilat e ndihmojnë për të kryer një detyrë apo veprimtari të caktuar dhe kërkon këshilla e informacion për kapërcimin e vështirësive. 	<ul style="list-style-type: none"> identifikon dhe krahason informacionet e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh.: duke i shënuar me shenja të ndryshme); zgjidh në mënyrë të pavarur problemin, detyrën e dhënë dhe prezanton para të tjerëve mënyrat e mundshme të zgjidhjes; identifikon cilësitë që zotëron dhe ato që duhen zhvilluar për të nxënë gjatë zhvillimit të një detyre apo veprimtarie të caktuar duke bashkëpunuar me të tjerët; përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informacionin /njohuritë për zgjidhjen e një problemi /detyre të caktuar, përmes shfrytëzimit të burimeve të tjera.
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin	
<ul style="list-style-type: none"> identifikon burimet e nevojshme (materiale, mjetet...etj.) dhe i përdor në mënyrë të drejtë për kryerjen e një detyre/aktiviteti në klasë, në shkollë, në mjedisin shtëpiak , në lagje/komunitet. 	<ul style="list-style-type: none"> paraqet në formë tabelare, grafike, vizatimi apo formë tjetër veprimtaritë e përkujdesjes për qeniet e gjalla, të cilat mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij.
Kompetenca personale	

<ul style="list-style-type: none"> bashkëpunon me të tjerët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në aktivitetet në klasë, shkollë apo jashtë saj. 	<ul style="list-style-type: none"> bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) drejt arritjes së një qëllimi të përbashkët. (projekti/ aktiviteti në bazë klase /shkolle apo jashtë saj).
Kompetenca qytetare	
<ul style="list-style-type: none"> diskuton dhe në bashkëpunim me anëtarët e grupit vendos rregullat në grup, në klasë, për realizimin e aktivitetit, mirësjelljes, pastërtisë etj. 	<ul style="list-style-type: none"> shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.
Kompetenca digjitale	
<ul style="list-style-type: none"> njih disa mjete të thjeshta të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. 	<ul style="list-style-type: none"> organizon, mbledh dhe shfaq të dhënat e gjetura nga burimet e informacionit elektronik.

5.3. Kompetencat matematikore që formohen përmes tematikave të saj

Bazuar në këtë kurrikul, lënda e matematikës synon të përmbushë 6 kompetenca, të cilat lidhen me kompetencat kyç që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet 5 tematikave kryesore.

Diagrama 1. Kompetencat matematikore




Tabela 2. Kompetencat matematikore që zhvillohen nëpërmjet tematikave

Kompetencat matematikore që zhvillohen përmes tematikave	Përshkrimi i kompetencave	Zhvillimi i kompetencave nëpërmjet tematikave
Zgjidhja e situatës problemore	<p>Nxënësi përshkruan dhe zgjidh situata problemore të nivelit praktik, të marra nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme dhe të nivelit abstrakt, duke zhvilluar kapacitetin e tij intelektual dhe intuitën krijuese.</p> <p><i>Treguesit kryesorë janë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - përcaktimi i të dhënave të situatës problemore; - modelimi i një situatë problemore; - zbatimi i hapave të ndryshme për zgjidhjen e situatës problemore; - vlefshmëria e zgjidhjes së situatës problemore; - paraqitja e zgjidhjes së situatës problemore. 	<p>Nxënësi përdor numrat, veprimet me to, llogaritjet me mend, matjet, konceptet gjeometrike, shprehjet algjebrike, grafikët, interpretimin e problemave, identifikimin e të panjohurave, zgjidhjen e ekuacioneve, diagramet, grafikët etj., për zgjidhjen e situatave problemore etj.</p>
Arsyetimi dhe vërtetimi matematik	<p>Nxënësi përdor arsyetimin, argumentimin dhe vërtetimin si aspekte themelore të matematikës. Arsyetimi ka të bëjë me organizimin logjik të fakteve, ideve ose koncepteve në mënyrë që të arrijë në një rezultat më të besueshëm se intuita.</p> <p><i>Treguesit kryesorë janë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - identifikimi i elementeve të situatës matematikore; - përdorimi i koncepteve matematikore dhe proceset e përshtatshme për situatën e dhënë; - arsyetimi për zbatimin e koncepteve dhe proceseve në situatën e dhënë. 	<p>Nxënësi përdor arsyetimin për veprimet me numrat, krahasimet, renditjet, zgjidhjen e ekuacioneve, interpretimin e shprehjeve algjebrike, për karakteristikat e figurave dhe trupave, transformimet gjeometrike, për interpretimin dhe formulimin e konkluzioneve etj.</p>
Të menduarit dhe komunikimi matematik	<p>Nxënësi përdor komunikimin nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit për të organizuar dhe qartësuar të menduarin matematik. Nxënësi gjatë komunikimit në gjuhën matematikore mëson konceptet, proceset dhe përforcon të kuptuarit e</p>	<p>Nxënësi përdor komunikimin për veprimet me numra, përkthimet me simbole, rezultatet e zgjidhjes së problemave, për interpretimin e vetive</p>

	<p>tyre. Ai kupton se kjo gjuhë përdoret jo vetëm në lëndë të tjera, por edhe në jetën e përditshme.</p> <p><i>Treguesit kryesorë janë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - familjariteti me gjuhën e matematikës; - lidhja e gjuhës së matematikës me gjuhën e përditshme; - interpretimi i koncepteve matematikore. 	të figurave e trupave, për interpretimin e të dhënave, tabelave, diagrameve etj.
Lidhja konceptuale	Nxënësi kupton ndërtimin e koncepteve matematike për të formuar një të tërë dhe përdor varësitë ndërmjet këtyre koncepteve. Arsyetimi matematik zhvillon lidhjen ndërmjet koncepteve duke i ndërtuar dhe zbatuar ato në proceset matematikore përkatëse.	Nxënësi përdor lidhjet konceptuale të numrave me ekuacionet, shprehjet algjebrike, problemave algjebrike dhe gjeometrike, drejtëzave, matjeve, të dhënave dhe probabilitetit, tabelave etj.
Modelimi matematik	Nxënësi përshkruan dhe krijon modele duke përdorur veprimet themelore matematikore në situata të jetës së përditshme. Modelimi është procesi i paraqitjes së situatës nga jeta reale me gjuhën matematikore. Njëpërmjet përdorimit të teknikave përkatëse, gjendet zgjidhja matematikore e cila më pas interpretohet në jetën reale.	Nxënësi modelon me anë të numrave, të simboleve, të shndërrimeve gjeometrike, në tabela, formulon ligjësi, formulon problema nga situata reale, ndërton e përdor formula etj.
Përdorimi i teknologjisë në matematikë	Nxënësi përdor teknologjinë si mjet për të zgjidhur apo verifikuar zgjidhjet, si dhe për të mbledhur, komunikuar e zbuluar informacione.	Nxënësi përdor makina llogaritëse për të kryer llogaritje të veprimeve me numra, përdor programe kompjuterike për prezantime, hulumtime, përpunime dhënash etj.

5.4. Koha mësimore

Lënda e matematikës zhvillohet për 2 javë mësimore me nga 10 orë secila (45 min), pra gjithsej 20 orë për secilën klasë. Në programin plotësues tematikat integrohen me njëra - tjetrën duke

ndërthurur orët sipas njohurive dhe shkathtësive.

5.5. Përmbajtja e programit plotësues sipas klasave

Tematikat *Numri, Matja, Gjeometria, Algjebra dhe funksioni, Statistika dhe probabiliteti* janë ndërthurur me njëra tjetrën. Njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat për secilën klasë, që duhet të demostrojë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse janë paraqitur në tabelat më poshtë.

5.5.1. KLASA E PARË

<p>Rezultatet e të nxënit për kompetencat matematikore:</p> <p><i>Zgjidhja problemore:</i> Kryen veprimet themelore matematikore me numra njëshifrorë dhe dyshifrorë. Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta.</p> <p><i>Arsyetimi dhe vërtetimi matematik:</i> Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, figurave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve. Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët.</p> <p><i>Të menduarit dhe komunikimi matematik:</i> Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme. Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t’u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme. Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me numra.</p> <p><i>Lidhja konceptuale:</i> Bën lidhje të thjeshta mes numërimit.</p> <p><i>Modelimi matematik:</i> Krijon modele të thjeshta të figurave dhe objekteve nga klasa dhe nga jeta e përditshme duke përdorur numrat. Paraqet numrat, konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.</p>	
<p>Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës</p>	<p>Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës</p>
<p>Krahasimi i numrave</p> <ul style="list-style-type: none"> - Krahasimi i dy numrave dhe sendeve duke përdorur shprehjet “më shumë”, “më pak”, “po aq”. <p>Mbledhja e zbritja</p> <ul style="list-style-type: none"> – Mbledhja dhe zbritja e dy numrave njëshifrorë; – Zbritja si veprim i kundërt i mbledhjes; 	<p>Nxënësi:</p> <p>Krahasimi i numrave</p> <ul style="list-style-type: none"> - krahason dy numra, grupe sendesh me mjete praktike duke përdorur shprehjet “më shumë”, “më pak”, “po aq”. <p>Mbledhja dhe zbritja</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mbledh dy numra njëshifrorë; - mbledh tre numra njëshifrorë duke zbatuar vetinë e ndërrimit të mbledhjes;

- Mbledhja e një numri dyshifror, me dhjetëshe të plota ose jo, me një numër njëshifror pa kalim të dhjetës.

Shumëzimi dhe pjesëtimi

- Dyfishimi i numrave njëshifrorë;
- Gjetja gjysmës së numrave çift (24,6,8,10) me anë të objekteve;
- Ndarja e numrave njëshifrorë në numra çift dhe tek;
- Ndarja e objekteve në një kontekst të dhënë në dy grupe të barabarta.

Strategji të veprimeve me mend

- Mbledhja e 3 numrave njëshifrorë ku dy prej numrave kanë shumën 10 (p.sh.: $4 + 3 + 6 = 10 + 3 = 13$);
- Përdorimi i numrave që kanë shumën 10 si urë për mbledhjen/zbritjen e numrave njëshifrorë (p.sh.: $8 + 3$, mbledhim $8 + 2 + 1 = 10 + 1 = 11$);
- Dyfishi i numrave 2 dhe 10.

Gjatësia

- Krahasimi i sendeve sipas gjatësisë me sy ose duke i vendosur njëri mbi tjetrin pa përdorur njësitë standarde;
- Përdorimi i terminologjisë përkatëse (“më i gjatë”, “po aq i gjatë”, “më i shkurtër”, “më i gjati”, “më i shkurtri”).

Koha

- Leximi i orës me orët e plota;
- Minuta, ora, dita, java, muaji dhe viti, renditja e ditëve të javës dhe e muajve të vitit.

Pesha

- Krahasimi i sendeve sipas peshës.
- Përdorimi i terminologjisë përkatëse (“më i rëndë”, “më i lehtë”, “po aq i rëndë”, “më i rëndi”, “më i lehti”);

Monedhat

- Njohja me monedhat nga 10- lekëshe deri në 100-lekëshe.

- zbret dy numra njëshifrorë;
- zgjidh problema me situata të njohura për ta.

Shumëzimi dhe pjesëtimi

- dyfishon numrat njëshifrorë;
- dallon me mjete praktike gjysmën e numrave njëshifrorë që ndahen në mënyrë të barabartë (numra çift njëshifrorë);
- ndan në dy grupe të barabarta një sasi objektësh të dhënë;
- zgjidh problema të thjeshta me mjete praktike nga situata të njohura për ta.

Strategji të veprimeve me mend

- përdor strategji të ndryshme për të kryer veprime të thjeshta me mend.

Gjatësia

- krahason drejtpërdrejt gjatësitë e sendeve, duke përdorur shprehjet: “më i gjatë”, “po aq i gjatë”, “më i shkurtër”, “më i gjati”, “më i shkurtri”;
- krahason me sy gjatësitë e dy ose më shumë sendeve.

Koha

- orientohet në kohë, duke përdorur fjalët e duhura (për shembull: dje, para një jave, tani, nesër, pas disa ditësh, pas dy muajsh etj.) në përcaktimin e kohës së shkuar, të tashme ose të ardhme;
- rendit ditët e javës, muajt e vitit;
- rendit ngjarje që kanë lidhje me jetën e tyre të përditshme, brenda një periudhe kohore prej një dite, disa ditësh, disa muajsh.

Pesha

- përdor terminologjinë përkatëse (“më i rëndë”, “më i lehtë”, “po aq i rëndë”, “më i rëndi”, “më i lehti”), për të shprehur masën e sendeve nga jeta e tij e përditshme.

Monedhat

- përdor monedhat nga 10-lekëshe deri në 100-lekëshe për të llogaritur çmime të sendeve nga

<p>– Parashikimi i mundësisë për një blerje që lidhet me një sasi të caktuar lekësh.</p> <p>Gjeometria në hapësirë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kubi, kuboidi, cilindër, kon, sferë <p>Shndërrimet gjeometrike</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vendndodhja dhe termat: para, pas, mbi, nën, majtas, djathtas, ndërmjet etj.; - Figura simetrike. <p>Ekuacione, inekuacione, sisteme të ekuacioneve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kutiza si vendmbajtëse numrash në barazime me mbledhje të dy numrave njëshifrorë me shumë deri në 20. <p>Funksioni</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dallimi i ligjësisë dhe vazhdimi i një modeli (vargu) konkret ose të vizatuar, sipas kësaj ligjësie që ka të bëjë me ngjyrën, formën ose madhësinë. <p>Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave</p> <ul style="list-style-type: none"> - Piktogramet. 	<p>jeta e tij e përditshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidh problema nga situata me blerje të njohura për ta. <p>Gjeometria në hapësirë</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon objekte praktike dhe ilustrime në formë kubi, kuboidi, cilindri, koni, sfera. <p>Shndërrime gjeometrike</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor termat: para, pas, mbi, nën, majtas, djathtas, ndërmjet etj., për të treguar vendndodhjen e një objekti, sendi, personi etj.; - dallon figura simetrike nga jeta e përditshme. <p>Zgjidhja e ekuacioneve, inekuacioneve, sistemeve të ekuacioneve</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjen numrin që duhet vendosur në kutizë në barazime me mbledhje ose me zbritje brenda numrit 20. <p>Funksioni</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe vazhdon një varg i cili ka të bëjë me ndryshimin sipas një ligjësie me një ose dy kritere (për shembull ndryshimi i ngjyrës dhe formës). <p>Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor piktogramet.
<p>Qëndrimet dhe vlerat</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij; - është inovativ dhe paraqet idetë e reja të tij; - organizon lidhjen konceptuale të njohurive; - përdor imagjinatën për zgjidhjen e problemeve; - vetëvlerësohet në situata të thjeshta; - demonstroi pavarësi në mendime dhe veprime; - demonstroi besim në forcat vetjake; - respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë; - demonstroi vullnet në arritjen e rezultateve; - respekton përpjekjet personale dhe ato në grup. 	

5.5.2. KLASA E DYTË

Rezultatet e të nxënit për kompetencat matematikore: <i>Zgjidhja problemore:</i> Kryen veprimet themelore matematikore me numra njëshifrorë dhe dyshifrorë. Identifikon kërkesat e situatave problemore të thjeshta. <i>Arsyetimi dhe vërtetimi matematik:</i> Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, figurave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve. Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët. <i>Të menduarit dhe komunikimi matematik:</i> Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme. Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t’u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme. Krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematikore. <i>Lidhja konceptuale:</i> Bën lidhje të thjeshta ndërmjet numrave, objekteve etj. <i>Modelimi matematik:</i> Krijon modele të thjeshta të figurave dhe objekteve nga klasa dhe nga jeta e përditshme duke përdorur numrat. Paraqet numrat, konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.	
Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
Numri natyror - Rrumbullakimi i numrave dyshifrorë në dhjetëshen më të afërt; - Paraqitja një numri dyshifror në boshtin numerik, në të cilën shënjohen shumëfishat e dhjetës; - Njohja dhe përdorimi i numrave rendorë (të paktën shumëfishat e dhjetës). Thyesat - Shkrimi i thyesave $1/2$; $1/3$; $3/4$; - E plota e shprehur në thyesë p.sh.: $2/2$ ose $4/4$; - Njohuri fillestare për thyesa të barabarta p.sh.: $1/2$ dhe $2/4$; - Gjysma, çereku, treçereku i figurave ose i një numri objektësh (me anë të mjeteve konkrete dhe të ilustrimeve). Mbledhja dhe zbritja	Nxënësi: Numri natyror - rrumbullakos numrat dyshifrorë në dhjetëshen më të afërt; - paraqet një numër dyshifrorë në boshtin numerik, në të cilën shënjohen shumëfishat e dhjetës; - njeh dhe përdor numrat rendorë (të paktën shumëfishat e dhjetës). Thyesat - shkruan thyesa $1/2$; $1/4$; $3/4$; - njeh që $2/2$ ose $4/4$ bëjnë një e plotë; - përcakton që $1/2$ dhe $2/4$ janë thyesa të barabarta; - identifikon figurat që janë ndarë në gjysmë ose një të katërtën dhe cilat jo; - gjen gjysmën dhe çerekun e figurave ose të një numri objektësh. Mbledhja dhe zbritja - mbledh dy numra dyshifrorë; - gjen ndryshesa të vogla të dy numrave dyshifrorë. Shumëzimi dhe pjesëtimi - kupton pjesëtimin si grupim; - përdor simbolin “:” ;

<ul style="list-style-type: none"> - Mbledhja e dy numra dyshifrorë; - Ndryshesa të vogla të dy numrave dyshifrorë. <p>Shumëzimi dhe pjesëtimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëtimi si grupim; - Përdorimi i simbolit të pjesëtimit “:”; - Dyfishi i numrave dyshifrorë. <p>Strategji të veprimeve me mend</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbledhja me çiftim i shumëfishave të 10 me shumë 100; - Shumëfishat e 2, 5 dhe 10 duke shprehur vetitë e shumëzimit dhe pjesëtimit; - Dyfishi për numra më të mëdhenj se 10 (përfshirë 15, 20, 25 dhe 50). <p>Monedhat</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohja me monedhat; - Llogaritja e blerjeve që lidhet me një sasi të caktuar lekësh (monedha). <p>Vëllimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëllimi i lëngjeve në enëve në mënyrë konkrete (me njësi standarde litrin); - Krahasimi i vëllimit të lëngjeve në enë. <p>Gjeometria në hapësirë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kubi, kuboidi, cilindër, kon, sferë, piramidë. <p>Shndërrimet gjeometrike</p> <ul style="list-style-type: none"> - Figura simetrike; - Drejtëza e simetrisë; - Lëvizja, pozicioni, drejtimi orar dhe kundërorar. <p>Funksioni</p>	<ul style="list-style-type: none"> - gjen dyfishin e shumëfishave të 5-ës duke e lidhur me gjysmën; - dyfishon numrat dyshifrorë. <p>Strategji të veprimeve me mend</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor strategji të ndryshme për të kryer veprime të thjeshta me mend; - shpjegon strategji dhe arsyeton veprimet. <p>Monedhat</p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh dhe përdor të gjitha monedhat; - përdor simbolet e parave; - llogarit shuma me monedha me çmime të sendeve nga jeta e tij e përditshme. <p>Vëllimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerëson (me sy), mat dhe krahason vëllimin duke përdorur njësitë standarde dhe jostandarde si dhe mjete të ndryshme matje; - krahason vëllimin e enëve të ndryshme të njohura për ta, duke përdorur njësitë standarde (litrin). <p>Gjeometria në hapësirë</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon, emërton, krijon format 3D (kubi, kuboidi, koni, cilindri, sfera dhe piramida) dhe vetitë e tyre; - njeh trupat format 3D që përbëhen nga figura 2D. <p>Shndërrime gjeometrike</p> <ul style="list-style-type: none"> - identifikon simetrinë në figura 2D apo modelime të tjera; - vizaton drejtëzën e simetrisë; - dallon figura simetrike nga jeta e përditshme; - ndjek dhe jep instruksione për pozicione, drejtime apo lëvizje të ndryshme; - njeh rrotullimin e plotë, gjysmë, çerek me drejtim orar apo kundërorar, - njeh që një kënd i drejtë është një çerek rrotullimi. <p>Funksioni</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan dhe vazhdon një model duke numëruar me dy, tre, katër ose pesë numra sipas një ligjësie. <p>Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor piktogramet për të prezantuar rezultatet;
---	--

<ul style="list-style-type: none"> - Dallimi i ligjesisë dhe vazhdimi i një modeli konkret ose të vizatuar, sipas kësaj ligjësie. <p>Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave</p> <ul style="list-style-type: none"> - Grafikët në shtyllë dhe piktogramet. 	<ul style="list-style-type: none"> - përdor diagramin e Venit për të klasifikuar numrat dhe objektet sipas një ose dy cilësive; - shpjegon zgjedhjen duke përdorur gjuhën e përshtatshme.
<p>Qëndrimet dhe vlerat</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zbulon situata problemore dhe gjëgjëza; - zgjidh problema të thjeshta (më një ose dy hapa të thjeshta) me mbledhje, zbritje, shumëzim ose pjesëtim; - krijon situata që zgjidhen me llogaritje përfshirë edhe kontekste me përdorimin e lekëve; - verifikon rezultatin duke renditur numrat në mënyra të ndryshme; - gjykon nëse një përgjigje është e argumentuar; - demonstroi pavarësi në mendime dhe në veprime; - vetëvlerësohet në situata të thjeshta; - demonstroi besim në forcat e veta; - respekton përpjekjet personale dhe ato në grup. 	

5.5.3. KLASA E TRETË

<p>Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:</p> <p><i>Zgjidhja problemore:</i> Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë; Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; Zbaton strategji të zgjidhjes së problemeve.</p> <p><i>Arsyetimi dhe vërtetimi matematik:</i> Demonstroi të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, figurave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; Dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët.</p> <p><i>Të menduarit dhe komunikimit matematik:</i> Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme; Përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme.</p> <p><i>Lidhja konceptuale:</i> Bën lidhje të thjeshta mes numërimit.</p> <p><i>Modelimi matematik:</i> Krijon modele të thjeshta të figurave dhe objekteve nga klasa dhe nga jeta e përditshme duke përdorur numrat dy shifror; Paraqet numrat, konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.</p> <p><i>Përdorimi i teknologjisë në matematikë:</i> Përdor mjete të thjeshta për kalkulime në mënyrë që të zgjidh probleme të ndryshme matematikore.</p>
--

Njohuritë për realizimin e kompetencave matematikore	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave matematikore
<p>Thyesat</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjysma e numrave çift dhe tek deri në 40, duke përdorur edhe shënimin e numrit të përzier, (p.sh.: $3\frac{1}{2}$). - Thyesat e barabarta. - Numrat e përzier si: $1\frac{1}{2}$ apo $2\frac{1}{4}$. - Vendosja e thyesave në boshtin numerik. - Pjesa e një numri ose figure (përgjigja numër natyrorë). <p>Shumëzimi dhe pjesëtimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tabela e shumëzimit me 2, 3, 4, 5, 6, 9 dhe 10 dhe pjesëtimi si veprim i anasjelltë. - Shumëzimi i numrave 10 deri në 19 me 3 dhe 5. - Pjesëtimi i numrave dyshifrorë edhe përtej tabelës së shumëzimit, p.sh.: $60:5$, $33:3$. - Pjesëtimi si veprim i kundërt i shumëzimit. - Mbetja gjatë pjesëtimit (mbeten edhe disa për t'u ndarë). - Vetinë e ndërrimit të shumëzimit. <p>Strategji të veprimeve me mend</p> <ul style="list-style-type: none"> - Veprime me mend për mbledhjen, zbritjen shumëzimin dhe pjesëtimin. <p>Paraja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monedhat deri në 1000-lekëshe. - Kombinime monedhash që tregojnë të njëjtën vlerë në lekë. <p>Koha</p>	<p>Nxënësi:</p> <p>Thyesat</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjen gjysmën e numrave çift dhe tek deri në 40, duke përdorur shënimin e numrit të përzier, (p.sh.: $3\frac{1}{2}$); - përdor konceptin e thyesës për të shprehur pjesë të së tërës, (p.sh.: $\frac{3}{4}$ tre të katërtat); - njeh thyesat e barabarta ndër disa thyesa të dhëna $\frac{1}{2}$, $\frac{2}{4}$, $\frac{4}{8}$ dhe $\frac{5}{10}$ me ndihmën edhe të diagramit; - njeh numra të përzier si: $1\frac{1}{2}$ apo $2\frac{1}{4}$; - rendit thyesat ose numrat e përzier në një bosht numerik, p.sh.: duke përdorur njohurinë që $\frac{1}{2}$ ndodhet ndërmjet $\frac{1}{4}$ dhe $\frac{3}{4}$, ndërsa $1\frac{1}{2}$ ndodhet ndërmjet 1 dhe 2; - njehson gjysmën, të tretën, të katërtën dhe të dhjetën e një numri ose figure (përgjigja numër natyror). <p>Shumëzimi dhe pjesëtimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - shumëzon një numër njëshifrorë me 2, 3, 4, 5, 6, 9 dhe 10 dhe pjesëton në mënyrë të anasjelltë; - shumëzon numra 10 deri në 19 me 3 dhe 5; - fillon të pjesëtojë numrat dyshifrorë edhe përtej tabelës së shumëzimit, p.sh.: $60:5$, $33:3$; - kupton pjesëtimin si veprim i kundërt i shumëzimit; - kupton mbetjen gjatë pjesëtimit, (mbeten edhe disa për t'u ndarë); - kupton dhe zbaton vetinë e ndërrimit të shumëzimit; - shkruan fakte që lidhen me shumëzimin dhe me pjesëtimin; - zgjidh situata problemore duke përdorur veprimet dhe algoritmin e tyre; - verifikon rezultatet duke përdorur makinën llogaritëse. <p>Strategji të veprimeve me mend</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor strategji të ndryshme për të kryer veprime të thjeshta me mend; - shpjegon strategji dhe arsyeton veprimet. <p>Paraja</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor konceptin e parasë;

<ul style="list-style-type: none"> - Njësiti e kohës sekonda, minuta, ora, dita, muaji, viti. - Matja e kohës deri në 5 minutëshin më të afërt. - Renditja e ngjarjeve. - Kalendari. <p>Vëllimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Litri, mililitri. <p>Shndërrimet gjeometrike</p> <ul style="list-style-type: none"> - Figura simetrike. - Drejtëza e simetrisë. - Lëvizja, pozicioni, drejtimi orar dhe kundërorar. - Rrjeta e katrorëve. <p>Funksioni</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dallimi i ligjesisë dhe vazhdimi i një modeli konkret ose të vizatuar, sipas kësaj ligjësie. <p>Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave</p> <ul style="list-style-type: none"> - Grafikët në shtyllë dhe piktogramet. 	<ul style="list-style-type: none"> - përdor veprime (mbledhje dhe zbritje) me përdorimin e parave. <p>Koha</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor njësiti e kohës dhe marrëdhënien ndërmjet tyre (sekonda, minuta, ora, dita, java, muaji, viti); - lexon orën me akrepa dhe orën digjitale në 5 minutëshin më të afërt; - fillon të llogarisë intervale të thjeshta në orë dhe minuta; - lexon kalendarin dhe llogarit intervalet në ditë dhe javë. <p>Vëllimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh lidhjen ndërmjet litrit dhe mililitrit; - përdor mjete të shkallëzuara <p>Shndërrime gjeometrike</p> <ul style="list-style-type: none"> - vizaton dhe plotëson një figurë sipas një drejtëze simetrie; - përdor instruksione për pozicione, drejtime apo lëvizje të ndryshme me drejtim orar ose kundërorar; - gjen dhe përshkruan pozicionin e një katrori në një rrjet katrorësh; - përdor rrjetin e katrorëve për të vizatuar kënde të drejta; - krahason kënde me këndin e drejtë. <p>Funksioni</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan dhe vazhdon një model duke numëruar me dhjetëshe sipas një ligjësie. <p>Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor piktogramën, tabelën e dendurive, diagramin shtyllë për të prezantuar rezultatet; - përdor diagramin e Venit për të klasifikuar numrat dhe objektet sipas një ose dy cilësive.
<p>Qëndrimet dhe vlerat</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kryen lirshëm veprimet me numra; - demonstroi kuriozitet për matematikën; - organizon lidhjen konceptuale të njohurive; - përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve; 	

- vetëvlerësohet dhe përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të thjeshta;
- demonstron besim në forcat vetjake;
- beson në përdorimin e teknologjisë për verifikimin e rezultateve;
- demonstroi vullnet në arritjen e rezultateve;
- respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.

5.5.4. KLASA E KATËRT

Rezultatet e të nxënimit për kompetencat e fushës:

Zgjidhja problemore: Kryen veprimet themelore matematikore me numra katërshifrorë; Identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; Zbaton strategji të zgjidhjes së problemeve.

Arsyetimi dhe vërtetimi matematik: Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, objekteve dhe situatave praktike; dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët.

Të menduarit dhe komunikimit matematik: Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme; krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me numra;

Lidhja konceptuale: Bën lidhje të thjeshta mes numërimit.

Modelimi matematik: Krijon modele të thjeshta të figurave dhe objekteve nga klasa dhe nga jeta e përditshme duke përdorur numrat konceptet matematikore; paraqet numrat, konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.

Përdorimi i teknologjisë në matematikë: Përdor mjete të thjeshta për kalkulime në mënyrë që të zgjidh probleme të ndryshme matematikore.

Njohuritë për realizimin e kompetencave matematikore	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave matematikore
<p>Numrat natyrorë, dhjetorë dhe të plotë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi i numrit dhjetor me dy shifra pas presjes për të konvertuar njësi matjeje, p.sh.: 125 cm në metra. - Koncepti i numrave negativë në kontekstin e temperaturave - Numrat çift dhe tek. <p>Thyesat</p> <ul style="list-style-type: none"> - Krahasimi i dy thyesave me emërues të njëjtë. - Renditja e disa thyesave me emërues të njëjtë. 	<p>Nxënësi:</p> <p>Numrat natyrorë, dhjetorë dhe të plotë</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor kuptimin e numrit dhjetor me dy shifra pas presjes (e dhjeta, e qindta) për të konvertuar njësi matjeje, p.sh.: 125 cm në metra; - përdor konceptin e numrave negativë në kontekstin e temperaturave; - njeh numrat çift dhe tek. <p>Thyesat</p> <ul style="list-style-type: none"> - krahason dy thyesa me emërues të njëjtë; - rendit disa thyesa me emërues të njëjtë; - njeh thyesat e barabarta ndër disa thyesa të dhëna $\frac{1}{2}$, $\frac{2}{4}$, $\frac{4}{8}$ me $\frac{5}{10}$ ose $\frac{1}{4}$ me $\frac{2}{8}$, $\frac{1}{5}$ me $\frac{2}{10}$; - përdor barazimin e thyesave për t'i renditur ato, p.sh.:

<ul style="list-style-type: none"> - Thyesa të barabarta. - Barazimi i thyesave me numrat dhjetorë me një shifër mbas presjes. - Renditja e thyesave dhe numrave të përzierë në boshtin numerik. 	<p>5/8 me $\frac{3}{4}$;</p> <ul style="list-style-type: none"> - një barazimin ndërmjet thyesave dhe numrave dhjetorë me një shifër mbas presjes, p.sh.: $\frac{1}{2}$ e barabartë me 0,5 dhe me 5/10; - një barazimin ndërmjet thyesave dhjetorë dhe thyesave të thjeshta si gjysma, të katërtat, të dhjetat dhe të qindtat; - një numra të përzierë si $5\frac{3}{4}$ dhe i rendit ato në boshtin numerik.
<p>Shumëzimi dhe pjesëtimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave treshifrorë me 10 (përgjigje numër natyrorë). - Njohuri fillestare për konceptet e raportit dhe përpjesëtimet. 	<p>Shumëzimi dhe pjesëtimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - shumëzon dhe pjesëton numrat treshifrorë me 10 (përgjigje numër natyror); - fillon të kuptojë konceptet e raportit dhe përpjesëtimet, p.sh.: një fotografi është një e pesta e masës reale, pra nëse fotografia është 25 cm e gjatë, masa reale është 5 x 25 cm;
<p>Strategji të veprimeve me mend</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kryen veprime mend për mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin e numrave natyrorë dhe thyesorë duke përdorur strategji të përshtatshme. 	<ul style="list-style-type: none"> - zgjidh situata problemore duke përdorur veprimet dhe algoritmin e tyre; - verifikon rezultatet duke përdorur makinën llogaritëse. <p>Strategji të veprimeve me mend</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor strategji të ndryshme për të kryer veprime të thjeshta me mend; - shpjegon strategji dhe arsyeton veprimet.
<p>Gjatësia dhe masa.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësitë standarde: km, m, cm, mm, kg, g. - Numrat dhjetorë gjatë matjeve. - Këmbime me njësi të ndryshme. 	<p>Gjatësia dhe masa</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjedh dhe përdor njësitë dhe objekte matjeje e përshtatshme; - një lidhjen ndërmjet kilometrit, metrit, centimetrit dhe milimetrit, kilogramit dhe gramit për të vlerësuar afërsisht dhe për të kryer matje në situata praktike; - përdor numra dhjetorë gjatë matjeve të ndryshme, p.sh.: 1,3 m; 0,6 kg;
<p>Koha</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësitë e kohës sekonda, minuta, ora, dita, muaji, viti. - Matja e kohës deri në minutin më të afërt. - Kalendarit. - Tabela e orareve intervalet. 	<ul style="list-style-type: none"> - përdor mjete të shkallëzuara; - zgjidh situata problemore nga jeta e përditshme ku përfshihen matjet.
<p>Vëllimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Litri, mililitri. 	<p>Koha</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon dhe tregon orën në minutën më të afërt në orën me akrepa dhe orën digjitale; - përdor sistemin 12 orësh për të treguar orën; - llogarit intervale të thjeshta në orë dhe minuta;
<p>Shndërrimet geometrike</p>	<ul style="list-style-type: none"> - lexon tabela orare, kalendarin dhe llogarit intervalet nga situata praktike.

<ul style="list-style-type: none"> - Lëvizja, pozicioni, drejtimi orar dhe kundërorar. - Rrjeta e katrorëve. <p>Funksioni</p> <ul style="list-style-type: none"> - Dallimi i ligjesisë dhe vazhdimi i një modeli konkret ose të vizatuar, sipas kësaj ligjësie. <p>Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave</p> <ul style="list-style-type: none"> - Veçimi dhe klasifikimi i një grupi objektësh, sipas një ose dy cilësive të përbashkët. - Digramet në shtyllë dhe oiktogramet. - Intervalet në diagramet në shtyllë. - Diagrami i Venit. 	<p>Vëllimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - një lidhjen ndërmjet litrit, centilitrit dhe mililitrit; - përdor mjete të shkallëzuara. <p>Shndërrime gjeometrike</p> <ul style="list-style-type: none"> - identifikon pozicionin e një katrori në një rrjet katrorësh; - një që këndet matën me gradë dhe një rrotullim i plotë është 360^0 ose 4 kënde të drejta; - krijon drejtime për të ndjekur një rrugë të dhënë. <p>Funksioni</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan dhe vazhdon një model duke numëruar sipas një ligjësie. <p>Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave</p> <ul style="list-style-type: none"> - i përgjigjet një pyetje nga jeta e përditshme duke grumbulluar, zbuluar ose klasifikuar të dhëna në një listë ose tabelë; - përdor piktogramën tabelën e dendurive, diagramin shtyllë për të prezantuar rezultatet; - përdor intervalet me 2,5, 10 ose 20 njësi në diagramin shtyllë; - krahason paraqitjet kur diagramat ndërtohen me intervale të ndryshme; - përdor diagramin e Venit për të klasifikuar numrat dhe objektet sipas një ose dy cilësive.
<p>Qëndrimet dhe vlerat:</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjedh strategji të përshtatshme për të kryer veprime me mend ose me shkrim; - paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij; - demonstroi kuriozitet për numrat; - organizon lidhjen konceptuale të njohurive; - përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve me numra; - vetëvlerësohet dhe përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të thjeshta; - beson në përdorimin e teknologjisë për llogaritje me numra; - respekton punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë; - demonstroi vullnet në arritjen e rezultateve. 	

5.5.5. KLASA E PESTË

<p>Rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës:</p> <p><i>Zgjidhja problemore:</i> Kryen veprimet themelore matematikore me numra dyshifrorë; identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; zbaton strategji të zgjidhjes së problemave.</p> <p><i>Arsyetimi dhe vërtetimi matematik:</i> Demonstron të kuptuarit e konceptit të numërimit përmes numrave, ngjyrave, figurave, madhësive, vizatimeve dhe objekteve; dallon dhe klasifikon ligjësi, për të gjykuar për hamendësime nëpërmjet diskutimeve me të tjerët.</p> <p><i>Të menduarit dhe komunikimit matematik:</i> Komunikon të menduarin matematik nëpërmjet të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit duke përdorur gjuhën e përditshme; përdor fjalorin fillestar të matematikës për t'u shprehur matematikisht nëpërmjet paraqitjeve të ndryshme; krijon paraqitje të koncepteve të thjeshta matematike me numra.</p> <p><i>Lidhja konceptuale:</i> Bën lidhje të thjeshta mes numërimit.</p> <p><i>Modelimi matematik:</i> Krijon modele të thjeshta të figurave dhe objekteve nga klasa dhe nga jeta e përditshme duke përdorur numrat dy shifrorë; Paraqet numrat, konceptet e thjeshta matematikore duke i ndërlidhur ato me situata konkrete.</p> <p><i>Përdorimi i teknologjisë në matematikë:</i> Përdor mjete të thjeshta për kalkulime në mënyrë që të zgjidh probleme të ndryshme matematikore.</p>	
<p>Njohuritë për realizimin e kompetencave matematikore</p>	<p>Shkathtësitë për realizimin e kompetencave matematikore</p>
<p>Numrat natyrorë, dhjetorë dhe të plotë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi i numrit dhjetor me dy shifra pas presjes (e dhjeta, e qindya). - Rrumbullakimi i një numri dhjetor me dy shifra pas presjes në numrin e plotë më të afërt. - Renditja dhe krahasimi i numrave pozitivë dhe negativë në një bosht numerik ose në shkallën e termometrit. - Renditja e numrave dhjetorë me një shifër ose dy shifra pas presjes. <p>Thyesat</p> <ul style="list-style-type: none"> - Barazimi ndërmjet thyesave dhe numrave dhjetorë, p.sh.: 	<p>Nxënësi:</p> <p>Numrat natyrorë, dhjetorë dhe të plotë</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor kuptimin e numrit dhjetor me dy shifra pas presjes (e dhjeta, e qindta) dhe gjen vlerën për secilën shifër; - rrumbullakos një numër dhjetor me dy shifra pas presjes në numrin e plotë më të afërt; - rendit dhe krahason numra pozitivë dhe negativë në një bosht numerik ose në shkallën e termometrit; - rendit numra dhjetorë me një shifër ose dy shifra pas presjes. <p>Thyesat</p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh marrëdhënien ndërmjet $1/2$, $1/4$ dhe $1/8$; $1/3$ dhe $1/6$; $1/5$ dhe $1/10$; - njeh barazimin ndërmjet thyesave dhe numrave dhjetorë, p.sh.: thyesa gjysma, të dhjetat dhe të qindtat; - kthen një thyesë më të madhe se 1 në numër të përzier, p.sh.: $7/4$ në $1\frac{3}{4}$; - rendit numrat e përzier në një bosht numerik; - lidh thyesën me pjesëtimin. <p>Përqindja</p>

<p>thyesa gjysma, të dhjetat dhe të qindtat.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Thyesat më të mëdha se 1 dhe numrat e përzier. - Lidhja e thyesës me pjesëtimin. <p>Përqindja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përqindja si numri i pjesëve ndër 100. <p>Mbledhja dhe zbritja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbledh ose zbritja e dy numrave dhjetorë me të njëjtën numër shifrash mbas presjes. <p>Shumëzimi dhe pjesëtimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shprehjet deri në katër veprime përfshirë edhe kllapat. <p>Strategji të veprimeve me mend</p> <ul style="list-style-type: none"> - Strategji të kryerjes së veprimeve me mend për mbledhjen, zbritjen, shumëzimin dhe pjesëtimin. <p>Koha</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njësitë e kohës: sekonda, minuta, ora, dita, muaji, viti. - Matja e kohës me sistemin 24 –orësh. - Kalendarit. - Tabela e orareve, intervalet. <p>Perimetri dhe syprina</p> <ul style="list-style-type: none"> - Formula për syprinën e drejtkëndëshit. <p>Shndërrimet gjeometrike</p> <ul style="list-style-type: none"> - Simetria. - Drejtëza e simetrisë. - Njohuri fillestare për zhvendosjen paralele. - Rrjeti koordinativ. 	<ul style="list-style-type: none"> - kupton përqindjen si numri i pjesëve ndër 100 dhe njehson përqindje të thjeshta; - shpreh gjysmën, të dhjetat dhe të qindtat si përqindje. <p>Mbledhja dhe zbritja</p> <ul style="list-style-type: none"> - mbledh ose zbrit dy numra dhjetorë me të njëjtën numër shifrash mbas presjes. <p>Shumëzimi dhe pjesëtimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - njehson rezultatin e shprehjeve deri në katër veprime përfshirë edhe kllapat. <p>Strategji të veprimeve me mend</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor strategji të ndryshme për të kryer veprime të thjeshta me mend; - shpjegon strategji dhe arsyeton veprimet. <p>Koha</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor njësitë e kohës: sekonda, minuta, ora, dita, java, muaji, viti; - përdor sistemin 24- orësh për të treguar orën; - lexon tabelat e orareve me sistemin 24- orësh; - llogarit intervale të thjeshta në orë, minuta dhe sekonda; - përdor kalendarin dhe llogarit intervalet në ditë dhe javë nga situata të jetës reale; - llogarit intervalet e kohës në muaj dhe vite. <p>Perimetri dhe syprina</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor formulën për syprinën e drejtkëndëshit; <p>Shndërrime gjeometrike</p> <ul style="list-style-type: none"> - ndërton figura simetrike; - krijon modele nëpërmjet dy simetrive boshtore të njëpasnjëshme; - lexon dhe vendos koordinatat në kuadratin e parë të rrjetit koordinativ; - kupton zhvendosjen si një lëvizje paralele në një vijë të drejtë. <p>Zgjidhja e ekuacioneve, inekuacioneve, sistemeve të ekuacioneve</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjen numrin që duhet vendosur në kutizë në barazime me mbledhje ose me zbritje. <p>Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor piktogramën tabelën e dendurive, diagramin shtyllë për të prezantuar rezultatet;
--	---

<p>Ekuacione, inekuacione, sisteme të ekuacioneve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kutiza si vendmbajtëse numrash në barazime me mbledhje të dy numrave me katër - pesë shifra. <p>Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave</p> <ul style="list-style-type: none"> - Digramet në shtyllë dhe grafikët me vija. - Intervalet në diagramet në shtyllë. - Moda. - Probabiliteti. - Mundësi që një ngjarje të ndodhë. 	<ul style="list-style-type: none"> - përdor intervalet me 2,5, 10, 20 ose 100 njësi në diagramin shtyllë; - ndërton grafik të thjeshtë me vijë, p.sh.: për të paraqitur ndryshimin e temperaturës me kohën; - krahasimi i grafikëve me vija, p.sh. paraqitja e ndryshimit të temperaturës me kohën dhe ardhja e nxënësve në shkollë çdo ditë të javës; - gjen modën në një grup të dhënash. <p>Probabiliteti</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan me gjuhën e mundësisë që një ngjarje familjare të ndodhë.
<p>Qëndrimet dhe vlerat:</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zbaton algoritmin e veprimeve me mend dhe me shkrim; - demonstroi kuriozitet për numrat; - organizon lidhjen konceptuale të njohurive; - përdor imagjinatën dhe kreativitetin për zgjidhjen e problemeve me numra; - vetëvlerësohet dhe përdor mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të thjeshta; - demonstroi pavarësi në mendime dhe në veprime; - beson në përdorimin e teknologjisë për llogaritje me numra; - demonstroi vullnet në arritjen e rezultateve; - respekton përpjekjet personale dhe ato në grup. 	

5.5.6. Udhëzime metodologjike për zhvillimin e programit plotësues të matematikës

Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënësve është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Mësimdhënia e matematikës e cila udhëhiqet nga parimi që “çdo nxënësi është i aftë të mësojë matematikë”, synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca, mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien e nxënien e integruar. Nxënësit e një klase janë të ndryshëm,

për sa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete etj.

Planifikimi dhe përzgjedhja metodave të mësimdhënies në mësimin e matematikës mban parasysh:

- kompetencat kryesore të të nxënës të matematikës;
- lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohuri edhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet;
- formimin dhe forcimin e aftësive bazë matematikore;
- rëndësinë e zbatimeve praktike, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet matematike me situata të jetës reale;
- veçoritë e punës individuale dhe të punës në grup;
- nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënës në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë komplementarë të njëri-tjetrit.

Gjithashtu, është e rëndësishme që **nxënësi të punojë me situata të nxënës** ku i kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si: “Pse?”, “A është gjithmonë e vërtetë?”, “Çfarë ndodh kur..?” etj. Në këtë mënyrë ai nxitet të reflektojë mbi veprimet e veta dhe të ndërmarrë situata të reja. Përmes situatave të të nxënës, nxënësi eksploron, aplikon dhe integron njohuritë dhe aftësitë matematikore, fiton aftësi intelektuale të nevojshme për të zhvilluar të menduarit matematik, bëhet i vetëdijshëm për aftësitë e tij dhe arrin të ketë një qëndrim të caktuar edhe me njerëzit që e rrethojnë.

Nxënësit me nevoja të veçanta

Qasja e nxënës me kompetenca merr parasysh dallimet mes nxënësve në klasë, të cilat përshtaten me përmbajtjen që ata do të mësojnë, me strategjitë e të nxënës, si dhe me materialet që mund të shfrytëzojnë gjatë mësimin. Mësuesi, për ta organizuar dhe zbatuar në mënyrë të suksesshme mësimdhënien për nxënësit me nevoja të veçanta, duhet të mbështetet në motivimin, aftësitë, interesat dhe stilet e të nxënës të nxënësve. Mësuesi përdor forma të ndryshme të organizimit të nxënës për nxënësit të cilët kërkojnë trajtim të veçantë dhe kanë nevoja të veçanta arsimore përfshirë edhe *nxënësit me vështirësi në të nxënë*. Mësuesi organizon gjithëpërfshirjen duke krijuar mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit në aktivitete brenda klasës, shkollës dhe jashtë

saj, si dhe duke nxitur e motivuar nxënësit për të marrë pjesë në veprimtari në grup, veprimtarinë çift apo nxënie individuale.

Programi plotësues ***nuk ka vlerësim të nxënësve***, por me anë të metodave dhe të teknikave të përdorura gjatë procesit të mësimdhënie –nxënies mësuesi nxit përparimin e nxënësit. Zhvillimi i programit plotësues në lëndën e matematikës do të zhvillohet kryesisht nëpërmjet lojërave, konkurseve, kuiceve, punëve në grup, situatave konkrete nga jeta e nxënësve, aktiviteteve në oborrin e shkollës, krijimtarisë, përsëritjes etj.